**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

Nr. 23/16
Datë: 22.06.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2021, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

2. Obligohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Komisionit të Pavarur të Mediave
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta*
*Ministry of Culture, Youth & Sports*

# KONCEPT DOKUMENTI PËR FUSHËN E TË DREJTËS SË AUTORIT

**Përgatitur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

**Maj, 2021**

# Përmbajtja

Përmbledhje e koncept dokumentit ..... 3
Hyrje ..... 6
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit ..... 7
Kapitulli 1.2.: Përafrimi me të drejtën e BE-së ..... 24
Kapitulli 2: Objektivat ..... 321
Kapitulli 3: Opsionet ..... 343
Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim ..... 343
Kapitulli 3.2.: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore .. 364
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë ndryshimi i kornizës aktuale legjislative ..... 376
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme ..... 39
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave ..... 465
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi ..... 476
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve ..... 510
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme ..... 510
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet ..... 587
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm ..... 62
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin ..... 632
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik ..... 654
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore ..... 687
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore ..... 721
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore ..... 743

# Përmbledhje e koncept dokumentit

| **Informacionet e përgjithshme** | |
|---|---|
| Titulli | Draft Koncept Dokumenti për Fushën e të Drejtës së Autorit |
| Ministria bartëse | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Zyra për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta] |
| Personi kontaktues | 03820022563 |
| PPQ 2021 | Lista e Koncept Dokumenteve për Vitin 2021 |
| Prioriteti strategjik | Strategjia Kombëtare për Fuqizimin e Sistemit të Drejtës së Autorit 2019-2023<br><br>**Objektiva 1:** Avancimi i kornizës legjislative;<br>**Objektiva 2:** Promovimi, edukimi dhe rritja e respektit për të drejtën e autorit;<br>**Objektiva 3:** Përmirësimi i bashkëpunimit mes palëve të interesit. |

| **Vendimi** | |
|---|---|
| Çështja kryesore | **Zbatimi i ulët i të drejtave të autorit dhe ngecjet në fushën e menaxhimit kolektiv** |
| Përmbledhje e konsultimeve | Nga procesi i konsultimit ndërministror që u zhvillua për koncept dokumentin, nuk ka mosmarrëveshje me ministritë tjera të linjës. Përkatësisht nuk ka çështje të ngritura. |
| | [Listoni aktivitetet kryesore të konsultimit publik të realizuar. Gjithashtu shënoni datën e fillimit dhe datën e përfundimit të konsultimit publik online me shkrim. Listoni numrin e organizatave që ofruan përgjigje në këtë konsultim, numrin e komenteve të marra dhe përfundimet kryesore nga procesi i konsultimit publik. Referojuni raportit për konsultimin publik që duhet të dorëzohet së bashku me koncept dokumentin për miratim nga Qeveria.] |
| Opsioni i propozuar | Opsioni i shqyrtuar dhe i rekomanduar është ndryshimi i kornizës aktuale legjislative. Ky opsion nënkupton hartimin e një ligji të ri, i cili do të rregullonte zbrazëtirat ligjore të hasura dhe do të rregullonte sfidat e reja të krijuara si rrjedhojë e zhvillimeve teknologjike të fundit. Në të njëjtën kohë do të përafrohej legjislacioni vendor me të BE-së dhe me traktatet ndërkombëtare, me zhvillimet e fundit ligjore.<br>Ky opsion do të jepte zgjidhje problemeve me të cilat janë ballafaquar mbajtësit e të drejtave po edhe shfrytëzuesit në vendin tonë. |

| **Ndikimet kryesore të pritshme** | |
|---|---|
| Ndikimet buxhetore | Zbatuar sipas tavanit aktual të buxhetit. |
| Ndikimet ekonomike | Me zbatimin më të mirë në praktikë të drejtave të autorit përmes opsionit të rekomanduar do të kishim këto ndikime:<br><br>- Ulja e veprimtarisë ilegale për sa i përket shkeljes së të drejtave të autorit, që do të ndikonte në rritjen e numrit të prodhuesve vendor, të cilët prodhojnë mallra dhe vepra origjinale dhe do të mund ti eksportonin të njëjtat, pra mund të këtë rritje të eksportit.<br>- Do të ndikojë në rritjen e konkurrueshmërisë, bizneset kosovare, duke tregtuar më pak mallra pirate, vakumi i krijuar do të duhej mbushur me mallra origjinale qofshin vendore apo të jashtme, gjë që do të ndikojë dhe në rritje të inovacionit dhe në ulje të çmimeve.<br>- Do të ketë rritje të investimeve, një treg me më pak mallra pirate dhe tregti ilegale;<br>- Tregu do të ishte më i besueshëm, si rrjedhojë kompanitë si vendore por dhe të huaja do të jenë më të prira të investojnë në tregun e Kosovës;<br>- Duke e rregulluar këtë fushë ligjërisht, luftimi i përmbajtjeve ilegale online do të përmirësonte dukshëm tregun dhe do të krijonte të ardhura të ligjshme, pra do kishte ngritje të të ardhurave nga e drejta e autorit si pjesëmarrje e përgjithshme në prodhimin e brendshëm bruto në vitet e ardhshme në Republikën e Kosovës. |
| Ndikimet shoqërore | Opsioni i rekomanduar do të ketë ndikime shoqërore:<br><br>- Do të ndikojë në informimin dhe edukimin e publikut, ku nëpërmjet fushatave dhe trajnimeve qytetarët do të jenë më të informuar për çështjet të drejtës së autorit.<br>- Do të krijoj incentiva për të krijuar vepra dhe investuar në industri kreative.<br>- Do të ndikojë në rritjen e sigurisë dhe uljen e krimit në vend, pasi që në bazë të studimeve të Interpolit grupet kriminale zakonisht merren me pirateri apo tregtim të mallrave pirate. |
| Ndikimet mjedisore | Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori. |
| Ndikimet ndër-sektoriale | Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori. |
| Ngarkesat administrative për kompanitë | Nuk vlen. |
| Testi i NVM-ve | Nuk është aplikuar, sepse nuk rregullohen çështje që në mënyrë direkete apo indirekte prekin NVM. |

| **Hapat e ardhshëm** | |
|---|---|
| Afatshkurtër | Aktivitetet më të rëndësishme që do të zhvillohen brenda një viti pas miratimit të koncept dokumentit, janë si në vijim:<br>- Avancimi i kornizës legjislative - nënkupton harmonizimin e plotë të legjislacionit vendor me atë të Acquis Communitare;<br>-<br>- Miratimi i Ligjit të ri për të drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. |
| Afatmesëm | Aktivitetet më të rëndësishme që do të zhvillohen brenda dy deri pesë vjetëve pas miratimit të koncept dokumentit, janë si në vijim:<br>- Miratimi i akteve nënligjore bazuar në ligjin e ri për të drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;<br>- Aktivitete për promovim, edukim dhe rritje të respektit për të drejtën e autorit. Përfshirë aktivitete paraqitjen e ndryshimeve legjislative dhe instituteve të reja ligjore;<br>- Përmirësimi i bashkëpunimit mes palëve të interes, trekëndëshit institucione mbajtës të të drejtave (shoqata kolektive) dhe shfrytëzues. |

# Hyrje

*Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin*

| | |
|---|---|
| Titulli | Koncept Dokumenti për Fushën e të Drejtës së Autorit |
| Ministria bartëse | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Zyra për të Drejtën e Autorit |
| Personi kontaktues | Zjarrta Osmani, 03820022563 |
| PPQ | Lista e Koncept Dokumenteve për Vitin 2021 |
| Prioriteti strategjik | Strategjia Kombëtare për Fuqizimin e Sistemit të Drejtës së Autorit 2019-2023, Objektiva - Avancimi i kornizës legjislative – Objektivi Specifik 1.1. |
| Grupi punues | Në grupin punues për hartimin e Koncept Dokumentin kanë marrë pjesë:<br>Përfaqësuesit e Zyrës për të Drejtën e Autorit;<br>Përfaqësuesi i Departamentit Ligjor të MKRS;<br>Përfaqësuesi i DIEKP-se në MKRS;<br>Një ekspert i çështjeve të fushës së pronësisë intelektuale vendor;<br>Përfaqësuesi i Sekretariatit të Qeverisë;<br>Eksperti i Angazhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në kuadër të Projektit të Pronësisë Intelektuale.<br><br>Ndërsa janë palët e konsultuar gjatë procesit kanë qenë: Shoqatat Kolektive (VAPIK dhe APIK); Institucionet Shtetërore relevante (Prokuroria, Gjyqësori; Policia - Departamenti i krimeve ekonomike dhe Departamenti i krimeve kibernetike; Dogana; Këshilli i Pavarur i Medieve; Inspektorati i Tregut; Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Zyra e Kryeministrit etj;) Bizneset në Kosovë (operatorët kabllorë, ofruesit e shërbimeve të internetit, shtëpitë botuese etj), Palët tjera (Shoqëria Civile; Odat Ekonomike etj.) dhe qytetarët e thjeshtë dhe mbajtësit e të drejtave. |
| Informata shtesë | Përveç nevojave tjera koncept dokumenti del edhe si rezultat i zbatimit të MSA nenin 77, në lidhje me obligimin e Republikës së Kosovës për të përafruar legjislacionin vendor me atë të Bashkimit Evropian. |

# Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta u shërben pikësynimeve të dyfishta, ruajtjes dhe zhvillimit të kulturës kombëtare si dhe ofrimit të mjeteve për eksploatim komercial në tregjet vendore dhe ndërkombëtare të veprave të mbrojtura. Duke shërbyer në këtë mënyrë si nxitje për kreativitet, krijimtari kulturore dhe garanci për kompensime adekuate të krijuesve dhe ndërmarrëseve në vendin tonë.

Të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta në Kosovë janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës nenin 46 paragrafi 5 dhe të rregulluara me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (LDADP). Me legjislacionin aktual janë rregulluar të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, respektivisht janë rregulluar marrëdhëniet që dalin nga kjo fushë në mes të subjekteve të ndryshme. Për më tepër, legjislacioni i fushës së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta rregullon në detale: të drejtat e autorit që, në bazë të pronës intelektuale, u takojnë autorëve përkitazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit, në vijim e drejta e autorit; pastaj rregullon të drejtat që, në bazë të pronës intelektuale, janë të përafërta me të drejtat e autorit, në vijim të drejtat e përafërta, që u takojnë interpretuesve përkitazi me interpretimet e tyre; prodhuesve të fonogrameve përkitazi me fonogramet e tyre; producentëve të filmit përkitazi me video-gramët e tyre; shërbyesit medial Audio-vizual përkitazi me transmetimet e tyre; prodhuesve të bazave të të dhënave përkitazi me bazat e tyre të të dhënave; botuesve përkitazi me botimet e tyre; gjithashtu rregullon edhe administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta; pastaj rregullon mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në gjykatat kompetente; dhe i njëjti rregullon edhe zbatimin e këtij ligji ndaj personave të huaj.

Por edhe pse vendi ka një legjislacion modern dhe që rregullon në detale marrëdhëniet juridike nga fusha e të drejtës së autorit dhe pasojat për cenimin e tyre, *është evident fakti që vendi ynë përballet më një zbatim jo të kënaqshëm të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta* për shkaqe të cilat do të analizohen dhe adresohen me koncept dokumentin. Përkatësisht problemet janë evidente në shkeljet e të drejtave të autorit në ambientin digjital dhe një funksionim jo adekuat i sistemit të menaxhimit kolektiv të të drejtave në fushën e transmetimit dhe atë të komunikimit publik të veprave, përdorimit të veprave të mbrojtura për qëllime komerciale pa marrëveshje me mbajtësit e të drejtave dhe vonesa në arritjen e marrëveshjeve të përgjithshme kolektive për përcaktimin e tarifave të përgjithshme për shfrytëzimin e të drejtës së autorit, mosekzistimi i neneve për lejimin e përdorimeve të caktuara të veprave dhe lëndës së mbrojtur me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta për nevojat e personave të verbër, me pengesa/kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp.

Ndërsa, vendi është i obliguar të krijoj një sistem funksional të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, ku ligji për të drejtën e autorit zbatohet dhe të drejtat respektohen dhe mbrohen kur ato cenohen, për këtë arsye është parë si e domosdoshme të bëhet një analizë e përgjithshme e politikave të cilat janë zbatuar në fushën e të drejtës së autorit.

Me këtë koncept dokument do të analizohen dhe adresohen politikat e zbatuara nga ana e institucioneve të vendit në fushën e të drejtës së autorit, nga koha kur është miratua Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe më vonë edhe Ligji Nr. 05/L -047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Gjithashtu, do të analizohet dhe adresohet implementimi i ligjeve dhe instrumenteve tjera ligjore edhe në aspekt të kërkesave për veprim të drejtuara nga ana e mbajtësve të drejtave dhe në aspekt të mbrojtjes ligjore të afruar nga ana e institucione për zbatimin e ligjit.

E drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta ndërlidhet ngushtë me legjislacion që rregullon veprimtarinë e institucioneve të zbatimit të ligjit, si të Inspektoratit të Tregut, Doganës së Kosovës, Policisë së Kosovës dhe të Gjykatave. Kjo ndërlidhje ka të bëjë vetëm më dispozitat në lidhje me zbatimin e të drejtave në praktikë, për këtë arsyeje do të analizohen dhe adresohen çështjet që kanë të bëjnë me zbatimit e të drejtave nga ana e institucioneve për zbatimin e ligjit.

Rëndësi e veçantë do të kushtohet çështjes së menaxhimit të të drejtave nga ana e mbajtësve të të drejtave, dhe posaçërisht do të analizohet praktikat e menaxhimit kolektiv të cilat janë zhvilluar deri më tani në vendin tonë, përfshirë edhe bazën ligjore për përcaktimin e tarifave të përgjithshme për shfrytëzimin e lëndës së mbrojtur nga ana e shfrytëzuesve të mëdhenj

Fusha e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta është një ndër fushat që ka më së shumti direktiva në kuadër të legjislacionit të BE-së, përkatësisht ekzistojnë disa direktiva të BE-së, të cilat janë shqyrtuar, analizuar dhe transpozuar kur janë miratuar Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat E Përafërta dhe Ligji Nr. 05/L -047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Por, BE-ja ka nxjerr edhe disa direktiva të reja me të cilat legjislacioni i të drejtës së autorit në vendin tonë nuk është i përafruar fare. Në këtë aspekt do të bëhet edhe një analizë e legjislacionit të vendit tonë dhe direktivave të BE-së, posaçërisht atyre me të cilat legjislacioni i venit tonë ende nuk është përafruar me qëllim të një përafrimi me dispozitat të cilat ndikojnë dhe garantojnë një menaxhim dhe zbatim efektiv të drejtave të autorit në vendin tonë, gjithherë duke siguruar një baraspeshë me shfrytëzuesit e të drejtave dhe të drejtat e këtyre të fundit.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët e interesit do hartoj draft koncept Dokumentin që do të i jap zgjidhje problemeve që do të identifikohen pas një analize në detale të problemeve dhe shkaqeve të tyre, dhe do të rekomandoj për Qeverinë e Republikës së Kosovës opsionet më të mira të cilat do të jenë më efikase dhe efektive për një zbatim më të mirë të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në vendin tonë, me qëllim që mbajtësit e të drejtave të kompensohen për veprat e tyre, por dhe të lehtësimit të përdorimit të veprave të mbrojtura për shfrytëzuesit e të drejtave. Në këtë aspekt do të arrihet edhe qëllimi i zbatimit të obligimeve të marra me Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim të lidhur me BE-në e cila ka paraparë obligime për harmonizim të legjislacionit dhe për një zbatim të një niveli të ngjashëm me vendet e BE-së.

*Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore*

| Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor | Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare | Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim | Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve) |
|---|---|---|---|
| Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta; | http://autori-ks.com/<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2787 | MKRS/Zyra për të Drejtën e Autorit/ZDA<br>Shoqatat Kolektive<br>Komisioni i Pavarur i Medieve/KPM,<br>Inspektorati i Tregut<br>Dogana/ SPI<br>Policia/<br>DHKEK dhe SHKK<br>KPM<br>Policia<br>Gjyqësori<br>Ministria E Drejtësisë<br>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë | **ZDA:** ka për kompetencë Hartimin e Legjislacionit dhe përcjelljen e zhvillimeve ligjore në nivel të Bashkimit Evropian dhe atë ndërkombëtar me qëllim që legjislacioni i fushës së të drejtës së autorit i aplikueshëm në Republikën e Kosovës është i harmonizuar dhe i adreson sfidat e kohës. Në këtë aspekt ZDA ka për kompetencë edhe informimin dhe Promovimin e të Drejtave të Autorit për Publikun e gjerë dhe mbajtësit e të drejtave. Si dhe ka kompetenca në licencimin e shoqatave kolektive dhe në mbikëqyrjen e tyre si dhe marrjen e licencës në rast |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | të keqpërdorimit.<br><br>**Komisioni i Pavarur i Mediave:** ka për detyrë krijimin e një ambienti të sigurt dhe të qëndrueshëm për transmetuesit në Kosove, duke i siguruar këta të fundit që të drejtat e tyre të transmetimit apo të ritransmetimit do të respektohen.<br><br>**Shoqatat Kolektive:** Shoqatat për administrimin kolektiv përveç qe bëjnë administrimin kolektiv të të drejtave te autorit dhe te drejtave te përafërta, në te njëjtën kohë janë një nga kontribuuesit e mëdhenj te informatave për shkeljen e të drejtave të autorit si dhe të drejtave të përafërta.<br><br>**Dogana:** Dogana e Kosovës në |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | kuadër të misionit fiskal, ekonomik dhe mbrojtjes, përmes instrumenteve ligjore ka për detyre edhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, me qellim të mbrojtjes së biznesit legal nga konkurrenca e pandershme.<br><br>**Policia:** Çështja e mbrojtjes së të drejtave të autorit hynë në kuadër të veprave penale kundër Ekonomisë. Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit si bazë ligjore kundër këtyre veprave e konsideron nenin 290 "Cenimi i të Drejtave të Autorit" si dhe Sektori i hetimeve të Krimeve Kibernetike në kuadër DKKO, bazuar në Ligjin mbi |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetikë Nr. 03/1-166, mund t'i trajtoj, gjegjësisht, hetoj format e Cenimit të Drejtave të Autorit përmes Teknologjisë Informative. Përveç këtyre veprimeve DHKEK, ka mandat që të koordinoj aktivitetet me institucione tjera të zbatimit të ligjit siç janë: Dogana e Kosovës, ATK, FIC, ZPI, ZDA e institucioneve tjera me qëllim të hetimit dhe parandalimit të këtyre aktiviteteve penale<br><br>**Inspektorati i Tregut:** Inspektorati i tregut ka për kompetencë për te kontrolluar rregullisht vendet e tregtimit, prodhimit, depot, vendet e punës dhe vendet tjera dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | për te siguruar se produktet apo shërbimet e vendosura në qarkullim nuk i cenojnë praktikat e mira afariste, nuk i dëmtojnë interesat e konsumatorëve dhe nuk janë në kundërshtim me praktikat e mira tregtare dhe mund te luaj rol të caktuar në luftimin, parandalimin e shkeljeve te drejtave të pronës intelektuale.<br><br>**Ministria e Drejtësisë** është që të zbatoj legjislacionin në fuqi dhe politikat e Qeverisë në fushën e drejtësisë, duke përfshirë këtu hartimin dhe ndjekjen e politikave në këtë fushë, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e funksioneve të tjera që për qëllim final kanë sundimin e |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | rendit dhe ligjit.<br><br>**Prokuroria:** Bazuar në Kodin Penal të Republikë së Kosovës ka kompetencë në hetimin e veprave penale që ndërlidhen me nenin 290 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës përkatësisht "Cenimi i të Drejtave të Autorit" dhe nenin 291 "Shmangja e Masave Teknologjike".<br><br>**Gjyqësori:** Gjykatat kanë për obligimi zbatimin e Ligjit për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në lidhje me kontestet në fushën e të drejtës së autorit dhe në lidhje me veprat penale që ndërlidhen me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Në këtë aspekt kompetente për kontestet në fushën e të |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | drejtës së autorit është gjykata Themelore e Prishtinës Departamenti për Çështje Ekonomike, ndërsa në lidhje me përgjegjësinë penale për shkeljen e të drejtave të autorit kompetentete në aspektin lëndor janë të gjitha gjykatat themelore në territorin e Replikës së Kosovës.<br><br>**Ministria e Arsimit** ka një rol kyç në edukimin qytetarë në çështjet e të drejtave autorit. Vetëdijesimi i publikut si dhe arsimimi në këto çështje janë ndër shtyllat kryesore të strategjisë për luftimin e piraterisë dhe falsifikimit. |
| Ligji Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2787 | MKRS/ZDA Shoqatat Kolektive/ VAPIK dhe APIK Dogana/ SPI | Institucionet shtetërore kanë përgjegjësi të njëjtë si më lartë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Autorit dhe të Drejtat e Përafërta | | Policia/ DHKEK dhe SHKK<br>KPM<br>Policia<br>Gjykata<br>Prokuroria<br>MASHT | |
| Rregullorja për Ndërmjetësim për te Kontesteve ne fushën e te drejtës se autorit dhe te drejtave te përafërta | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2787 | MKRS/ZDA<br>Shoqatat Kolektive/ Vapik dhe Apik<br>Ndërmjetësuesit | **ZDA** - ka kompetenca në shqyrtimin e kërkesave në lidhje me ndërmjetësimin me rastin e kontesteve për caktimin e tarifave të përgjithshme.<br>**Shoqatat Kolektive** – paraqiten si palë në kontestet në lidhje me tarifat e përgjithshme dhe procedura iniciohet me kërkesën e tyre.<br>Ndërmjetësuesit - kanë për obligim të përgjigjën në kërkesat për ndërmjetësim që paraqiten nga Shoqatat Kolektive dhe të zgjidhen këto raste sipas legjislacionit në fuqi. |
| Rregullorja për Procedurat e Dhënies përkatësisht marrjes se Lejes | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2787 | MKRS/ZDA<br>Shoqatat Kolektive | **MKRS/ZDA** – ka kompetenca në shqyrtimin e aplikimeve për licencim për |

| | | | |
|---|---|---|---|
| shoqatave për administrim kolektiv te te drejtave te autorit dhe te drejtave te përafërta | | | menaxhimin kolektive dhe në mbikëqyrje të punës së Shoqatave Kolektive.<br><br>**Shoqatat Kolektive** - kanë për obligim që konform ligjit për të drejtën e autorit të plotësojnë standardet dhe të aplikojnë për të marr licencë dhe të bëjë organizmin e brendshëm për menaxhimin. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| RREGULLORE PËR TË DREJTËN E KOMPENSIMIT TË VEÇANTË DHE REPROGRAFIK | http://autori-ks.com/?page=1,3 | MKRS/ZDA Dogana Shoqata Kolektive Inspektorati i Tregut | **Shoqatat Kolektive-** kanë kompetencë në menaxhimin e kompensimeve të veçanta.<br><br>**Dogana** – ka për obligim të informoj shoqatën kolektive kompetente në lidhje me subjektet që kanë importuar media të zbrazta për të cilat aplikohet kompensimi i veçantë.<br><br>**Inspektorati i Tregut** – ka kompetencë që të bëje mbikëqyrjen inspektuese në lidhje me atë nëse subjektet ka bërë pagesën e kompensimit të veçantë sipas rregullores. |
| Plotësim ndryshim i Rregullores për Ndërmjetësim për te Kontesteve ne fushën e te drejtës se autorit dhe te drejtave te përafërta | http://autori-ks.com/ | MKRS/ZDA Shoqatat | Shih me lartë tek Rregullorja për Ndërmjetësim për te Kontesteve ne fushën e te drejtës se autorit dhe te drejtave te përafërta. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Strategjia Kombëtare për Forcimin e Sistemit Të Së Drejtës Së Autorit 2019-2023 | http://autori-ks.com/ | MKRS/ZDA<br>Shoqatat Kolektive/ VAPIK, APIK<br>Dogana<br>Policia<br>KPM<br>Policia<br>Gjykata<br>Inspektorati i Tregut | Shih me lartë tek Institucionet shtetërore kanë përgjegjësi të njëjtë si më lartë. |
| Ligji për Komisionin e Pavarur te Mediave | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2809 | KPM<br>Shoqatat<br>MKRS/ZDA | **KPM:** ka për detyrë krijimin e një ambienti të sigurt dhe të qëndrueshëm për transmetuesit në Kosove, duke i siguruar këta të fundit që të drejtat e tyre të transmetimit apo të ritransmetimit do të respektohen. |
| Ligji për zbatimin e të Drejtave Pronësore Intelektuale nga Dogana e Kosovës | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16355 | MKRS/ZDA<br>Dogana | Shih me lartë tek përgjegjësitë e Doganës. |
| Ligji për inspektoratin e Tregut | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8667<br>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2703 | Inspektorati i tregut | Shih me lartë tek përgjegjësitë e Inspektoratit të Tregut . |
| Policia/ Drejtoria për Luftimin e Krimeve ekonomike dhe kibernetike | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2682 | MKRS/ZDA<br>Policia- Sektori për Krime Kibernetike dhe Krime Ekonomike | Shih me lartë tek përgjegjësitë e Drejtorisë për Luftimin e Krimeve ekonomike dhe kibernetike. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ligji për Barazi Gjinore/ Ligji kundër diskriminimit | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923 | MRKS/ZDA Agjencia për Barazi Gjinore | Zbatimi dhe bashkërendimi i të gjithë prioriteteve të identifikuar në Kornizën kombëtare të politikave gjinore, siç përshkruhet në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, është përgjegjësi e Agjencisë për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. |
| Kodi Penal i Republikës së Kosovës | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413 | Policia e Kosovës, Prokuroria Gjykata | Shih me lartë tek përgjegjësitë e Prokurorisë dhe Gjykatës. |

*Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet*

| | |
|---|---|
| **Efektet** | Prezenca e Piraterisë fizike dhe digjitale;<br><br>Mos funksionalizimi efikas i institucioneve të zbatimit të ligjit si pasoj mungesës se kapaciteteve;<br><br>Vetëdija qytetare e ulët , Mungesa e vetiniciativës nga mbajtësit e të drejtave për të mbrojtur të drejtat e tyre; shkelja e te drejtave te autorit nga mosdija; mungesa e vullnetit për te krijuar vepra origjinale si rezultat i mos informimit;<br><br>Prodhimi dhe futja ilegal në treg e veprave jo-origjinale ose veprave origjinale por pa pëlqimin e mbajtësit të të drejtave dhe shitja e tyre<br><br>Mos-ofrimi i shërbime dhe materiale origjinale nga mbajtësit e të drejtave |
| | Më pak të hyra për autorët; |

| | |
|---|---|
| | Dështimi i mbledhjes dhe shpërndarjes se mjeteve nga tarifat;<br>Dëmtimi material ekonomik dhe moral i autoreve;<br>Dekurajimi i krijuesve dhe novatorëve;<br><br>Mos përfshirja e shoqatave kolektive të Kosovës në rrjetin global të menaxhimit kolektiv;<br><br>Tej zgjatja e procesit në realizimin e të drejtave nga menaxhimi kolektiv; |
| | Mos-Avancimi i Legjislacionit të së Drejtës se Autorit:<br><br>Në hap me trendët sipas zhvillimeve teknologjike në lidhje me data Mining, Ambienti digjital më fer dhe lirinë e shtypit<br><br>Kufizimi i institucioneve për përdorimin e materialeve për qëllimi edukativo-arsimore dhe hulumtuese<br><br>Kufizimi i institucioneve për përdorimin e materialeve për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore<br><br>Mos ofrimi i lehtësirave për përdorimin e veprave nga personat e verbër, me pengesa apo kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp;<br><br>Mundësi të keqpërdorimit të kompensimeve të mbledhura nga shoqatat kolektive, mosbesim mes palëve të përfshira;<br><br>Shkelja e të drejtave të autorit; dëmtimi i imazhit të Kosovës;<br><br>Rrezikimi i anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare të pronësisë intelektuale si WIPO. |
| **Problemi kryesor** | **Zbatimi i ulët i të drejtave të autorit dhe ngecjet në fushën e menaxhimit kolektiv** |
| **Shkaqet** | Rregullat nuk zbatohen siç duhet:<br><br>Mungesa e Kapaciteteve Institucionale (inspektorati, policia, dogana, etj.) dhe njerëzore<br><br>Promovimi jo mjaftueshëm i të drejtave të autorit dhe mungesa e informimit dhe edukimit tek qytetaret për këto te drejta.<br><br>Inspektime jo të mjaftueshme dhe sistematike (inspektorati, policia) |

| | |
|---|---|
| | Mungesa e stimulimit të tregut-ngurrimi i bizneseve ne plasimin e veprave origjinale ne treg. |
| | Mos funksionalizmi i menaxhimit kolektiv:<br><br>Mosrealizimi i Kompensimeve të veçanta dhe mos përcaktimi i shoqatës kolektive për menaxhim te kompensimit te veçantë;<br><br>Vështirësitë në miratimin e tarifave të përgjithshme. |
| | Rregullat nuk janë të kompletuara:<br><br>Mos-transpozimi i Acquies të BE-së;<br><br>Llogaridhënia dhe transparenca e Shoqatave Kolektive;<br><br>Task Forca- mos përcaktimi i qartë i kompetencave dhe mandatit të saj;<br><br>Zbrazëtira juridike në sferën digjitale;<br><br>Mos rregullimi i përdorimit te veprave nga personat e verbër, me pengesa apo kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp. |

## 1.1.1. Problemi Kryesor

Duke përdorur Pemën e Problemit konkludojmë se problemi kryesor që hasim është Zbatimi i ulët i të drejtave të autorit dhe ngecjet në fushën e menaxhimit kolektiv. Ligji aktual mund të konsiderohet Ligj i mirë hartuar dhe që rregullon pothuajse në tërësi sistemin e së drejtës së autorit, por për arsye të vet natyrës të të drejtës së autorit pra natyrës evolutive të saj sot hasim sfida të reja të cilat nuk janë paraparë kur është hartuar Ligji aktual, siç është rasti i rritjes së shkeljeve në ambientin digjital. Me qëllim të mbajtjes së hapit me zhvillimet e të drejtës së autorit, është me rëndësi që këto ndryshime të përfshihen dhe në legjislacionin tonë, që përveç që do të rregullonte sistemin tonë po ashtu do të na ndihmonte të jemi në një nivel me shtetet e rajonit.

Mos ndryshimi i sistemit të të drejtës së autorit, vetëm sa do të përkeqësonte gjendjen më shumë me kalimin e kohës. Mbajtësit e të drejtave do të vazhdonin të dëmtoheshin, veçanërisht nga mosfunksionimi adekuat i shoqatave kolektive por dhe nga mungesa e kapaciteteve të institucioneve shtetërore siç janë Gjykata, Policia etj. Po ashtu palë e dëmtuar do të jenë personat e verbër, me pengesa apo kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp të cilëve do të ju

mohohej qasja në libra dhe vepra tjera të cilat me dispozitat e reja do të liroheshin për këtë kategori.

## 1.1.2. Shkaqet që kanë ndikuar në Problemin Kryesor

Shkaqet që kanë ndikuar në problemin e identifikuar janë ndarë në dy kategori, në kategorinë e parë ato që kanë të bëjnë me rregullat, përkatësisht me rregullat që nuk zbatohen siç duhet dhe me rregullat nuk janë të kompletuara, si dhe kategorinë që ndërlidhet me shkaqet të cilat kanë të bëjnë më funksionalizmin e menaxhimit kolektiv.

Te kategoria e parë e shkaqeve kryesisht kemi të bëjmë me mungesë të kapaciteteve njerëzore gjë që përkthehet në mos mundësinë e implementimit të ligjit aktual apo të rregullave ekzistuese, pra nuk kemi të bëjmë me zbrazëtira ligjore. Shembuj të kësaj janë institucionet e zbatimit të ligjit, siç është Dogana apo Inspektorati të cilat janë deklaruar se kanë mungesë të personelit ndërsa rasti tjetër janë institucionet e zbatimit të ligjit si Prokuroria dhe Gjykata ku hasim në mungesë të njohurive të mjaftueshme të të drejtave të autorit, i njëjti problem haset tek qytetarët në përgjithësi ku shihet se shumica nuk janë mirë të informuar se çka janë të drejtat e autorit dhe se çka përbën shkelje të të drejtave të autorit, si rrjedhojë e kësaj qytetarët bëjnë shkelje pa qenë të vetëdijshëm se në fakt janë duke e shkelur ligjin.

Po ashtu hasen sfida në fushën e transmetimit dhe atë të komunikimit publik të veprave, përdorimit të veprave të mbrojtura për qëllime komerciale pa marrëveshje me mbajtësit e të drejtave dhe vonesa në arritjen e marrëveshjeve të përgjithshme kolektive për përcaktimin e tarifave të përgjithshme për shfrytëzimin e të drejtës së autorit, mosekzistimi i neneve për lejimin e përdorimeve të caktuara të veprave dhe lëndës së mbrojtur me të drejtën e autorit. Ndërsa te promovimi kërkohet implementim më i suksesshëm i politikave informuese dhe promovuese.

Kategoria që ka të bëjë me Rregullat që nuk janë kompletuar, pra Ligji aktual nuk i rregullon këto çështje. Këtu hyn çështjet si: Menaxhimi i Shoqatave Kolektive më saktësisht llogaridhënia dhe Transparenca e tyre ndaj të gjitha palëve të interesit (ZDA, anëtarëve të shoqatës, shoqatave tjera, mbajtësve të të drejtave dhe publikut); mos përcaktimi i qartë i kompetencave dhe mandatit të Task-Forcës, ku kemi parë që në praktikë ndonëse Task-Forca funksionon dhe takimet mbahen me rregull ajo nuk ka kompetenca të veprojë dhe si e tillë nuk arrin të korr suksesin e dëshiruar; problem tjetër janë shkeljet në sferën digjitale por dhe nga mjetet teknologjike moderne, këtu kemi të bëjmë me teknologji të cilat nuk kanë qenë të përdoruara kur është hartuar ligji aktual në fuqi,

këto probleme i hasim dhe tek të drejtat e përafërta për nevojat e personave të verbër, me pengesa apo kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp pasi në ligjin aktual nuk janë të parapara.

Si dhe kategoria që ka të bëjë më funksionalizimin e menaxhimit kolektiv, ku janë paraqitur probleme kryesisht në përcaktimin e tarifave të përgjithshme, dhe mbledhjen e tyre nga ana e shfrytëzuesve, që ndërlidhet edhe me shkakun e vetëdijesimit më të madh që duhet të bërë për shfrytëzuesit e materialit të mbrojtur me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta.

## 1.1.3. Efektet

Si rezultat i shkaqeve të lartcekura jena prodhuar një sërë efektesh të cilat kanë ndikuar negativisht në sistemin e së drejtës së autorit.

Mungesa e kapaciteteve institucionale tek inspektorati i tregut, policia e Kosovës, prokuroria e gjyqësori, ka ndikuar direkt në mundësinë e tyre për të kryer punët në nivelin e kërkuar si rrjedhojë zbatimi i ligjit nuk është në nivelin e kërkuar. Deficiti institucional ndahet në dy kategori: ku një pjesë e institucioneve nuk e kanë numrin e nevojshëm të zyrtarëve andaj ka ngarkesë të punës për zyrtarët dhe shumica e institucioneve nuk janë të trajnuar mjaftueshëm në fushën e të drejtës së autorit dhe kjo ndikon që institucionet të mos dine se si më së miri ti qasen sfidave.

Mos zbatimi efektiv i ligjit ka ndikuar në nivelin e shkeljeve të të drejtave të autorit, kjo përveç që ka dëmtuar krijimtarinë, ekonominë, po ashtu ka dëmtuar imazhin e Kosovës karshi institucioneve ndërkombëtare dhe shteteve tjera, ku vlen të theksohet së në raportet e Komisionit Evropian për Kosovën vazhdimisht kërkohet një zbatim më i mirë të drejtave të autorit. Sistemi jo funksional ka ndikuar që mos të ofrohen shërbime dhe materiale origjinale nga mbajtësit e të drejtave, dhe kjo si rezultat vetëm sa rrit piraterinë pasi qytetarët kërkojnë qasje në materiale origjinale dhe shërbime por që nuk iu ofrohen.

Për shkak të mos rregullimit të saktë dhe mos zbatimit të dispozitave në fuqi, menaxhimi i shoqatave kolektive APIK[1] dhe VAPIK[2] nuk ka qenë në nivelin e duhur, ka dështuar mbledhja dhe shpërndarja e mjeteve nga tarifat; dëmtimi material ekonomik dhe moral i autorëve; dekurajimi i krijuesve dhe novatorëve; kjo po ashtu si efekt ka bërë që krijuesit të kenë mosbesim mes palëve, shoqatave dhe institucioneve shtetërore dhe të dyshohet në mundësi të

[1] APIK – është shoqatë për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në fushën e muzikës, e themeluar dhe licencuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Korrik të vitit 2010. Kjo shoqatë përfaqëson autorët, prodhuesit, interpretuesit e Kosovës në fushën e muzikës.

[2] VAPIK është shoqatë për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në fushën audio- vizuale. Kjo shoqatë përfaqëson autorët, prodhuesit dhe interpretuesit e Kosovës në fushën audio-vizuale. VAPIK është licencuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Korrik të vitit 2010.

keqpërdorimit të kompensimeve të mbledhura. Dështimi i procesit të menaxhimit kolektiv po ashtu ka ndikuar te mos përfshirja e shoqatave kolektive të Kosovës në rrjetin global të menaxhimit kolektiv.

Njohja e jo e mirë  e të drejtave të autorit nga qytetarët ngrit nevojën për vetëdijesim të vazhdueshëm, përndryshe kjo krijon mungesë të vetiniciativës nga mbajtësit e të drejtave për të mbrojtur të drejtat e tyre; shkelja e te drejtave te autorit nga mosdija; mungesa e vullnetit për te krijuar vepra origjinale si rezultat i mos informimit etj.

Si rrjedhoje e Rregullave të pakompletuara kemi mos-avancimin e Legjislacionit të së Drejtës së Autorit, e cila ndikon që Kosova të jetë një hap prapa trendëve teknologjike siç është çështja që ka të bëjë me data mining për qëllime hulumtuese, apo çështja e dhënies së mundësisë për personat e verbër, me pengesa apo kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp të cilëve do të ju mohohej qasja në libra dhe vepra tjera të cilat me dispozitat e reja do të liroheshin për këtë kategori, ku mos plotësimi i rregullave do të kishte efekte negative për të njëjtit.

## Kapitulli 1.2.: Përafrimi me të drejtën  e BE-së

Në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, ekzistojnë disa direktiva të BE-së dhe një rregullore, me të cilat shtetet anëtare kanë bërë harmonizimin e legjislacionit të tyre në këtë fushë.

Në lidhje me aplikimin e legjislacionit të fushës së drejtës së autorit të BE-së në Kosovë, Republika e Kosovës ka marr obligime me Marrëveshjen për Stabilizim Associm që të bëjë harmonizimin e plotë të legjislacionit dhe që vendi ynë brenda pesë viteve pas hyrjes së MSA-së në fuqi, në Republikën e Kosovës duhet të këtë zbatim dhe mbrojtjeje të ngjashme me vendet e BE-së. Për këtë arsyeje është domosdoshme që të bëhet një transpozim i plotë i legjislacionit dhe të merren të gjitha veprimet që të adresohet problemi i identifikuar për zbatim jo të kënaqshme dhe menaxhim kolektiv jo efikas të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në Republikën e Kosovës.

Në këtë aspekt duhet bërë dallimi i instrumenteve ligjore të BE-së me të cilat është përafruar legjislacioni ynë dhe me instrumentet ligjore me të cilat legjislacioni ynë ende nuk është përafruar.

Instrumentet ligjore të BE-së apo direktivat me të cilat legjislacioni i fushës së të drejtës së autorit i vendit tonë është i përafruar me direktivat e listuara më poshtë, megjithatë të njëjtave do të ju bëhet edhe një vlerësim i detajuar për të ri-konfirmuar pajtueshmërinë dhe janë me sa vijon:

- Direktiva 93/83/EEC e datës 27 Shtator 1993 e cila ka synuar lehtësimin e transmetimit ndërkufitar të programeve audio-vizuale, përkatësisht transmetimit me satelit dhe ritransmetimit kabllorë (OJ L 248, 06/10/1993);

- Direktiva 2001/29/EC të datës 22 Maj 2001 mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në shoqërinë e informacionit (OJ L 167, 22/06/2001);
- Direktiva 2001/84/CE e datës 27 Shtator 2001, mbi të drejtën e rishitjes, respektivisht përfitimin e autorit të një vepre origjinale të artit (OJ L 272, 13/10/2001);
- Direktivën 96/9EC e datës 22 Maj 2001, mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave, (OJ L 077, 27/03/1996);
- Direktiva 2006/115/EC e datës 12 Dhjetor 2006, për drejtat mbi qiradhënien dhe huazimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave e përafërta në fushën e të drejtave pronësore intelektuale (OJ L 376, 27/12/2006);
- Direktiva 2004/48/EC e datës 29 Prill 2004, mbi zbatimin e të drejtave pronësore intelektuale, (OJ L 195, 02/06/2004);
- Direktiva 2009/24/EC versioni i kodifikuar e datës 23 Prill 2009 e cila ka harmonizuar legjislacionin Evropian në lidhje me mbrojtjen e programeve Kompjuterike (OJ L 111, 05/05/2009);
- Direktiva 2011/77/EU të datës 27 Shtator 2011 mbi kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, (OJ L 265, 11/10/2011, p. 1 - 5), e cila direktivë ka ndryshuar Direktivën 2006/116/EC e datës 12 Dhjetor 2006 (OJ L 372, 27/12/2006, p. 12-18);
- Direktiva 2012/28/EU e datës 25 Tetor 2012 mbi përdorimin e lejueshëm të veprave jetime, (OJ L 299, 27/10/2012,).

Instrumentet ligjore të BE-së apo direktivat dhe rregulloret me të cilat legjislacioni i fushës së të drejtës së autorit i vendit tonë nuk është i përafruar, janë me sa vijon:

- **Direktiva 2014/26/EU për Menaxhimin Kolektiv të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta dhe licencimin shumë-territorial të drejtave në muzikë për përdorim në internet ne tregun e brendshëm të BE-së, (OJ L 84, 20.3.2014); Në këtë drejtim, grupi punues ka analizuar Direktivën 2014/26 në raport me legjislacionin vendor dhe ka identifikuar çështjet si ne vijim:**

  - Neni 3 - Direktiva e BE-së 2017/1564 nuk janë të harmonizuara me Direktivën;
  - Neni 5 - të drejtat e mbajtësit të së drejtës nuk janë të specifikuara ashtu siç parashihen me Direktivë;
  - Neni 6 - rregullat e anëtarësimit nuk parashihen me ligjin ekzistues;
  - Neni 7 - të drejtat e mbajtësve të së drejtës që nuk janë anëtarë të shoqatës nuk parashihen me ligjin ekzistues;
  - Neni 8 - Ky nen është pjesërisht i transponuar në ligjin ekzistues, mirëpo kompetencat e Kuvendit të përgjithshëm nuk janë të transpozuara;

- Neni 9 – Roli mbikëqyrës i shoqatës nuk rregullohet në mënyrë specifike me ligjin aktual;
- Neni 10 – Obligimet e personit përgjegjës që udhëheq punën e shoqatës nuk rregullohen në mënyrë specifike;
- Neni 11, 12, 13 – grumbullimi, ndalesa, shpërndarja dhe përdorimi i të hyrave nga të drejtat është pjesërisht i rregulluar, pasi që specifikat e tyre nuk përcaktohen me ligjin ekzistues; Neni 14, 15 – të drejtat e menaxhuara sipas marrëveshjeve për përfaqësim nuk janë të harmonizuara me Direktivë;
- Neni 16 – Kriteret për licencimin e përdoruesve nuk përcaktohen në ligjin ekzistues;
- Neni 17 – Detyrimet e përdoruesve ndaj shoqatës nuk parashihen me ligjin ekzistues;
- Nenet 18, 19, 20, 21, 22 – Kriteret mbi transparencën dhe raportimin janë të përgjithshme në ligjin aktual;
- Kapitulli III – nuk parashihet me ligj;
- Neni 33 – ligji ekzistues nuk përcakton mekanizmat e ankimit të brendshëm.

- **Direktiva e BE-së 2017/1564 për lejimin e përdorimeve të caktuara të veprave dhe lëndës së mbrojtur me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta për nevojat e personave verbër, me pengesa/kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp. Në këtë drejtim, grupi punues ka analizuar Direktivën 2014/26 në raport me legjislacionin vendor dhe ka identifikuar çështjet si ne vijim:**

- Neni 2 – definicion i ri duhet hartuar lidhur me personat që përfitojnë nuk janë të harmonizuara me Direktivën;
- Neni 3– përdorimet e lejueshme me direktivë duhet të zgjerohen me legjislacionin tonë;
- Neni 4 – autorizimi i autoriteteve nuk janë të harmonizuara me Direktivën;
- Neni 5 – obligimet e autoriteteve duhet harmonizuar me Direktivën;
- Neni 6 – transparenca dhe shkëmbimi i informacioneve e paraparë me direktivën duhet rregulluar me legjislacionin e vendit tonë.

- **Rregullorja e BE-së 2017/1563 për shkëmbimin ndërkufitar ndërmjet BE dhe vendeve të treta të për kopje në format të arritshëm të veprave të caktuara dhe lëndës tjetër të mbrojtur nga të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta për nevojat e personave që janë të verbër, me pengesa/kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp, (*OJ L 242, 20.9.2017*). Në këtë drejtim, grupi punues ka analizuar Direktivën 2014/26 në raport me legjislacionin vendor dhe ka identifikuar çështjet si ne vijim:**

- Neni 2 - definicion i ri duhet hartuar lidhur me personat që përfitojnë nuk janë të harmonizuara me Direktivën.

- Neni 3 - mundësia e eksportimit të veprave të kopjuar përafërta për nevojat e personave që janë të verbër, me pengesa/kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp duhet rregulluar;
- Neni 4 - mundësia e importimit të veprave të kopjuar përafërta për nevojat e personave që janë të verbër, me pengesa/kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp duhet rregulluar;
- Neni 5 - obligimet e autoriteteve duhet harmonizuar me Direktivën në lidhje me eksportin dhe importin e veprave për nevojat e personave që janë të verbër, me pengesa/kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp duhet rregulluar.

- **Rregullorja e BE-së 2017/1128 për Portabilitetin ndërkufitar të shërbimeve me përmbajtje online në tregun e brendshëm e BE-së, (OJ L 168, 30.6.2017); Në këtë drejtim, grupi punues ka analizuar Rregullorja e BE-së 2017/1128 në raport me legjislacionin vendor dhe ka identifikuar çështjet si ne vijim:**

Në lidhje me dispozitat e Rregullores e BE-së 2017/1128 për Portabilitetin ndërkufitar të shërbimeve me përmbajtje online në tregun e brendshëm e BE-së, do të shikohet mundësia e transpozimit që këto dispozita të vlejnë vetëm pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në BE, me meqenëse e rregullojnë çështjen e portabilitetit brenda territorit të BE-së dhe nuk do të mund të aplikoheshin në rastin e vendit tonë.

- **Direktiva e BE-së 2019/790 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në Tregun e Përbashkët Digjital dhe për ndryshimin e Direktivës 96/9/EC dhe Direktivës 2001/29 / EC, (OJ L 130, 17.5.2019). Në këtë drejtim, grupi punues ka analizuar Direktivën 2014/26 në raport me legjislacionin vendor dhe ka identifikuar çështjet si ne vijim:**

- Neni 2 - definicionet e parapara në lidhje me organizatat hulumtuese duhet hartuar dhe paraparë pasi që nuk janë pjesë e legjislacionit të vendit tonë.
- Neni 3 - "nxjerrja e të dhënave dhe tekstit" e njohur si "text and data mininig" me qëllim të hulumtimit shkencor, për riprodhimet dhe ekstraktimet e bëra nga organizatat kërkimore dhe institucionet e trashëgimisë kulturore në mënyrë që të kryejnë, për qëllime të kërkimit shkencor, nxjerrjen e tekstit dhe të dhënave të punimeve ose lëndës tjetër, në të cilën ata kanë qasje të ligjshme. si risi e paraparë me direktivë që duhet të bëhet pjesë e legjislacionit tonë.
- Neni 4 - përcaktimit përjashtimeve në lidhje me mundësinë e "nxjerrjes së të dhënave dhe tekstit" e njohur si "*text and data mininig*" për për riprodhimet dhe nxjerrjet e veprave të arritshme në mënyrë të ligjshme dhe lëndës tjetër për qëllime të përpunimit të tekstit dhe të dhënave.

- Neni 5 – Përdorimi i veprave dhe lëndëve të tjera për aktivitete mësimore digjitale dhe ndërkufitare duhet rregulluar.
- Neni 6 - Ruajtja e trashëgimisë kulturore, përkatësisht përcaktimi i përjashtimit dhe kufizimit në mënyrë që të lejojnë institucionet e trashëgimisë kulturore të bëjnë kopje të çdo vepre ose lëndë tjetër që janë përgjithmonë në koleksionet e tyre, në çfarëdo formati ose mediumi, për qëllime të ruajtjes së veprave të tilla ose lëndës tjetër dhe në masën e nevojshme për një ruajtje të tillë.
- Neni 7 – përcakton ndalimin e mënjanimit të përjashtimeve përmes dispozitave kontraktuese, dhe këtë duhet të bëhet pjesë e legjislacionit tonë- transpozohet.
- Neni 8 – në kuadër të masave për të përmirësuar praktikat e licencimit dhe sigurimin e qasjes më të gjerë të pranisë përdorimi i veprave dhe lëndës që nuk është në treg nga ana nga institucionet e trashëgimisë kulturore, pjesërisht e harmonizuar me legjislacionin tonë duhet harmonizohet plotësisht.
- Neni 9 - përdorimi ndër-kufitar i veprave, rregullon përdorimin e veprave në mes të shteteve anëtare të BE-së, transpozohet në fazat e më vonshme.
- Neni 10 - masat e publicitetit në lidhje me licencat dhe përdorimet e lejueshme nga ana e institucioneve përfituese, duhet të jenë transparente dhe publike, kjo çështje duhet të rregullohet edhe me legjislacionin tonë.
- Neni 11- Inkurajimi i dialogut në mes të palëve – përkatësisht shoqatave të menaxhimit kolektiv dhe të institucioneve dhe të përdoruesve të veprave, kjo çështje është e rregulluar pjesërisht me legjislacionin tonë, duhet të harmonizohet tutje.
- Neni 12- Masat për lehtësimin e licencimit kolektiv – pjesërisht të harmonizuara me legjislacionin tonë. Licencimi kolektiv me efekt të zgjeruar i paraparë me direktivë duhet të transpozohet në legjislacionin tonë.
- Neni 13 – mekanizmi i negocimit – është i plotësisht i harmonizuar me legjislacionin e vendit tonë.
- Neni 14 – Veprat e artit vizual në domenin publik – pjesërisht i harmonizuar. Duhet të plotësohet legjislacioni jonë në lidhje me riprodhimet origjinale në kuptim që janë krijime intelektuale të autorit.
- Neni 15 - Mbrojtja e publikimeve të shtypit në lidhje për përdorimin në internet të botimeve të tyre të shtypit nga ofruesit e shërbimeve të shoqërisë së informacionit. Duhet të harmonizohet në legjislacionin e vendit tonë.

- Neni 16 – Kërkesat për kompensimit adekuat për botuesit, pjesërisht e rregulluar, duhet të harmonizohet plotësisht.
- Neni 17 – Përdorimi i përmbajtjes së mbrojtur nga ofruesit e shërbimeve të internetit, duhet të transpozohet në legjislacionin e të drejtës së autorit. E pa rregulluar me legjislacion aktual.
- Neni 18 - Parimi i shpërblimit apo kompensimit adekuat dhe proporcional, parim ky i përfshirë në legjislacionin e vendit tonë.

- Neni 19 - Obligimi për transparence pjesërisht i përfshirë, duhet të përfshihet apo të transpozohet plotësisht.
- Neni 20 - mekanizmat për ri-përshtatjen e kontratës në lidhje me shfrytëzimin e veprës, përkatësisht autorët dhe interpretuesit ose përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të kërkojnë shpërblim shtesë, të duhur dhe të drejtë nga pala me të cilën ata kanë lidhur një kontratë për shfrytëzimin e të drejtave të tyre - legjislacioni i jonë plotësisht është i harmonizuar me këtë mekanizëm të direktivës.
- Neni 21 - Procedura alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve - legjislacioni i jonë plotësisht është i harmonizuar me këtë mekanizëm të direktivës.
- Neni 22 - Mundësia e tërheqjes, është e paraparë me legjislacionin e vendit tonë e harmonizuar me direktivën.
- Neni 23 - Dispozitat e përbashkëta, të parapara në lidhje me pamundësimin e anashkalimit të neneve 19, 20, dhe 21 të direktivës të përshkruara më lartë, përmes me dispozitave kontraktuale - e paraparë me legjislacionin e vendit tonë apo plotësisht në përputhje.

Komisioni Evropian në lidhje me direktivat ka kompetenca të kujdeset dhe të kërkoj që shtetet anëtare kanë bërë një transpozim të plotë të tyre në legjislacionin e secilit shtet anëtarë, ndërsa sa i përket kompetencave në lidhje me rregulloret Komisioni Evropian ka kompetenca të kontrolloj që rregulloret janë të aplikueshme drejtpërsëdrejti në të gjitha shtetet anëtare. Përgjegjësia e vendit tonë në lidhje me legjislacionin e BE-së është e ndërlidhur me MSA-në si u sqarua më lartë.

Figura e mëposhtme liston palët e interesuara të identifikuara. Gjithashtu tregon nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet ose të dyja. Përveç kësaj, kolona e fundit në përmbledhje tregon se si ato janë të prekura. Kapitulli 5 jep informacionin se si janë konsultuar këto palë të interesuara.

***Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit***

| Emri i palës së interesuar | Shkaku-qet dhe/ose efekti (efektet) me të cilat është e lidhur pala | *Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo* efektin (efektet) |
|---|---|---|
| Mbajtësit e te drejtave (krijues, përformues, autorë) | Vetëdija Qytetare | Mbajtësit e te Drejtave janë pak te informuar në lidhje me të drejtat e autorit |
| | Dëmtimi i krijimtarisë | Mos-informimi ndikon në dëmtimin e krijimtarisë për shkak se blerja e mallrave pirate dëmton ekonomikisht mbajtësit e te |

| | | |
|---|---|---|
| | kulturore, shkencore etj<br><br>Mos shfrytëzimi i të drejtave të tyre (te drejtat autoriale | drejtave, të cilët nuk kanë incentivë ekonomike me për te krijuar.<br><br>Mbajtësit e te drejtave kane të drejtë të padisin shkelësit e të drejtave të tyre autoriale por për shkak te procedurës të tej-zgjatur. |
| Përdoruesit e të Drejtave (operatoret kabllorë, transmetuesit radio-televiziv, ofruesit e shërbimeve të internetit, hotelet baret, dhe personat fizik etj.) | Vetëdija Qytetare<br><br>Zhvillimi i Tregtisë Jo-formale<br><br>Mungesa e shërbimeve dhe materialeve origjinale<br><br>Dëmtimi i krijimtarisë kulturore, shkencore etj. | Përdoruesit dhe operatoret e të Drejtave janë pak të informuar në lidhje me të drejtat e autorit<br><br>Përdoruesve ju ofrohen materiale pirate me çmime me të favorshme, me oferta me atraktive se sa blerja e materialeve origjinale<br><br>Ofruesit e shërbimeve me përmbajte origjinale nuk ofrojnë materialin e tyre direkt ne territorin e Kosovës.<br><br>Mos-informimi ndikon në dëmtimin e krijimtarisë për shkak se blerja e mallrave pirate dëmton ekonomikisht mbajtësit e te drejtave, te cilët nuk kane incentivë ekonomike me për te krijuar |
| Institucionet shtetërore:<br>MKRS<br>MTI<br>Dogana<br>Policia<br>Gjykata<br>Prokuroria<br>Inspektorati i tregut në nivel | Vënia në zbatim e Legjislacionit te te drejtave te autorit<br><br>Inspektime jo të mjaftueshme dhe sistematike | Mungesa e kapaciteteve njerëzore<br>Mungesa e njohurive specifike të fushës, në ambientin digjital |

| | | |
|---|---|---|
| qendror dhe komunal KPM | (inspektorati, policia) | |
| Gjykata Prokuroria | Vonesat në marrjen e vendimeve (gjyqësori, prokuroria, inspektorati) | Numri i madh i lendeve në procedurë civile dhe penale<br><br>Mos prioritetizimi i lëndëve të të drejtave të autorit |
| Palë të tjera të interesit: Shoqëria Civile, Odat e Ekonomike, Shoqatat Kolektive VAPIK dhe APIK, | Mungesa e njohurive/ vetëdija<br><br>Zhvillimi i Tregtisë Jo-formale | Mos-përfaqësimi i interesave të grupeve qe i përfaqësojnë si pasoje e mos vlerësimit të drejtë të të drejtave të autorit<br><br>Mos ndërmarrja e masave për anëtaret të cilët zhvillojnë tregti jo-formale; |

# Kapitulli 2: Objektivat

Objektivat janë paraparë me Strategjinë Kombëtare për Forcimin e Sistemit të së Drejtës së Autorit 2019 - 2023.

**Objektiva 1:** Avancimi i kornizës legjislative - nënkupton harmonizimin e plotë të legjislacionit vendor me atë të Acquis Communitare që është kusht që Kosova të mund të anëtarësohet në Bashkimin Evropian. Duke qenë që legjislacioni i BE-së gjithmonë shkon duke evoluuar si rrjedhojë ai plotësohet dhe herë pas here ndryshohet, e është e domosdoshme që Kosova të mund të mbajë hapin duke iu përshtatur ndryshimeve. Për të arritur këtë, korniza ligjore duhet rishikuar.

**Objektiva 2:** Promovimi, edukimi dhe rritja e respektit për të drejtën e autorit - ngritja e vetëdijes është element thelbësor për zhvillimin e sistemit të së drejtës së autorit. Ngritja e vetëdijes do të ndihmojë në krijimin e një shoqërie më mirë të informuar dhe edukuar në lidhje me të drejtën e autorit, gjë që do të ndikojë drejtpërdrejt në respektimin më të madh të të drejtave të autorit. Qytetarët do të kërkojnë të drejtat e tyre dhe kjo do të nxitë kreativitetin dhe si rrjedhojë do të zhvillojë ekonominë e vendit.

**Objektiva 3:** Përmirësimi i bashkëpunimit mes palëve të interesit - sistemi funksional efektiv i të drejtave të autorit për realizmin dhe zbatimin e këtyre të drejtave krijohet duke zhvilluar një bashkëpunim të mirë mes institucioneve të krijimit të politikave në këtë fushë dhe atyre të zbatimit të ligjit, por edhe me një bashkëpunim mes institucioneve dhe mbajtësve të të drejtave si dhe organizatave që përfaqësojnë ata. Vetëm duke pasur një bashkëpunim të mirë ndërinstitucional në aspekt të qarkullimit të informatave dhe realizimit të aktiviteteve të përbashkëta si dhe një bashkëpunim me mbajtësit e të drejtave në lidhje me sfidat që ata kanë për zbatimin e të drejtave të tyre mund të kemi një sistem funksional të të drejtave të autorit në vend.

*Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë*

| **Qëllimi i politikës: Respektimi dhe Avancimi i te Drejtave te Autorit** | **Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)** |
|---|---|
| Objektivi strategjik/Objektivi specifik | |
| **Objektiva Strategjike 1: Avancimi i kornizës te përgjithshme të të drejtave te autorit**<br><br>Objektivi Specifik 1.1: Hartimi i Legjislacionit primar dhe sekondar<br>Objektivi Specifik 1.2: Rritja e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për Sistemin Kombëtar të të Drejtave të Autorit | STRATEGJIA KOMBËTARE PËR FORCIMIN E SISTEMIT TË SË DREJTËS SË AUTORIT 2019-2023 |
| **Objektiva Strategjike 2: Promovimi, edukimi dhe rritja e respektit për të Drejtën e Autorit**<br><br>Objektivi Specifik 2.1: Edukimi dhe ngritja e vetëdijes nëpërmjet edukimit formal dhe joformal<br><br>Objektivi Specifik 2.2: Promovimi nëpërmjet fushatave vetëdijesuese (platforma online, TV me synim rritjen e interaktivitetit )<br><br>Objektivi Specifik 2.3: Inkurajimi i mbajtësve të të drejtave për krijimin e shoqatave te autoreve;<br><br>Objektivi Specifik 2.4: Inkurajimi i mbajtësve të të drejtave për mbrojtje të të drejtave;<br><br>Objektivi Specifik 2.5: Inkurajimi i mbajtësve për të ofruar përmbajtje të ligjshme; | |

| | |
|---|---|
| | |
| **Objektiva Strategjike 3: Përmirësimin e bashkëpunimit në mes të palëve të interesit**<br><br>Objektivi specifik 3.1: Ngritja e efikasitetit dhe të efektivitetit të Task Forcës kundër piraterisë<br><br>Objektivi specifik 3.2: Krijimi i forumeve të përbashkëta me bartësve të të drejtave SHMK-të dhe përdoruesit | |

# Kapitulli 3: Opsionet

Ky kapitull do të shtjellojë tre opsione se si do të mund të zgjidhnim problemet në sistemin e së drejtës së autorit. Opsionet e propozuara janë: Opsioni i parë, pa asnjë ndryshim - sipas të cilit vazhdohet me situatën aktuale dhe nuk ndërmerren veprime; Opsioni i dytë, për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore- sipas të cilit do të ndërmerren veprime për përmirësimin e mënyrave për arritjen e objektivave përmes zbatimit të duhur të detyrimeve ekzistuese ligjore, pa pasur nevojë për ndryshim të legjislacionit aktual; dhe Opsioni i tretë, i fundit ndryshimi i kornizës aktuale legjislative. Ky opsion nënkupton hartimin e një ligji të ri, i cili do të rregullonte zbrazëtirat ligjore dhe do të jepte zgjidhje adekuate për problemet e identifikuar.

# Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Nëse zgjedhim opsionin e parë, do të vazhdohet me politikat aktuale dhe me zbatimin e legjislacionin në fuqi. Ky opsion paraqet ngecje të zhvillimit të sistemit të të Drejtës së Autorit, rrjedhimisht do të vazhdohej me problemet aktuale të cilat hasim dhe sot dhe me gjasa serioze të përkeqësimit të gjendjes me kalimin e kohës.

Ky opsion sjell sfida të mëdha për sistemin e së drejtës së autorit, sfidat kryesore që kemi identifikuar janë në:

- Menaxhimin Kolektiv;
- Shkeljet e të Drejtës së Autorit, veçanërisht në hapësirën digjitale;
- Sfidat për Personat e verbër dhe me nevoja të veçanta në shikim dhe shtyp;

- Harmonizimi me Acquis;
- Mungesa e informimit të qytetarëve dhe mbajtësve të të drejtave;
- Vënia në zbatim jo e kënaqshme e të Drejtës së Autori nga institucionet publike

Sfidat e lartcekura mund të i klasifikojmë në dy kategori, ato që do të sjellin ngecje të plotë dhe ato që do të sjellin ngecje të pjesshme.

Sfidat që sjellin ngecje të plotë, me zgjedhjen e opsionit të parë nuk do të ndryshoje fare situata, në fakt gjasat janë reale që do të përkeqësohet, siç është në rastin e shkeljeve në ambientin digjital të cilat do të shumëfishohen fal zhvillimit të hovshëm të teknologjisë. Në aspektin digjital shkeljet janë edhe më pakë të identifikuara dhe të paraqitura në institucionet ligj zbatuese, për këtë arsyeje edhe mungojnë edhe statistikat të cilat mund të paraqesin gjendjen reale të zbatimit të drejtave të autorit në ambientin digjital.

Sfidat që sjellin ngecje të pjesshme janë ato të cilat jo medoemos do të qëndrojnë plotësisht të pandryshueshme, ato do të ndryshojnë gradualisht për të mirë me kalimin e kohës por që kjo nuk do të ndikojë në përmirësimin e sfidave tjera, pra do të japin efekt jo të kënaqshëm në zbatimin e të drejtës së autorit në Republikën e Kosovës.

Sfidat që sjellin ngecje të plotë hasen në menaxhimin kolektiv, veçanërisht në përcaktimin e tarifave të përgjithshme, do të vazhdojnë procedurat e ndërlikuara në përcaktimin e tarifave gjë që ka ndikuar negativisht në procesin e mbledhjes së kompensimeve për mbajtësit e të drejtave; dhe në llogaridhënien si dhe raportimin e shoqatave kolektive; nuk do të përmirësohej gjendja në ambientin digjital, ku hasim shkelje të mëdha të të drejtave të autorit, dhe gjasat janë që kjo gjendje do të përkeqësohet me kalimin e kohës.

Sfidat për Personat e verbër dhe me nevoja të veçanta në shikim dhe shtyp do të mbesnin të pa rregulluara pasi ende nuk janë të rregulluara me legjislacionin aktual në fuqi; ngecje do të kishte edhe në harmonizimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së gjë që do të ndikonte për keq në përmbushjen e obligimeve që dalin nga Marrëveshjes së Stabilizim Asociim, mosharmonizimi i legjislacionit me atë të BE-së dhe atë të ndërkombëtar do të paraqiste probleme edhe në marrëdhëniet bilaterale me vendet tjera, duke rrezikuar edhe anëtarësimin e mundshëm të vendin në organizatat ndërkombëtare të pronësisë intelektuale.

Sfidat që paraqesin ngecje të pjesshme janë: mungesa e informimit, ku ne vlerësojmë se në përgjithësi qytetarët dhe institucionet e Kosovës janë pak të informuar në lidhje me të Drejtat e Autorit, politikat aktuale të ZDA-së përfshijnë dhe informimin dhe promovimin e të drejtave të autorit dhe me zgjidhjen e këtij opsionin do të vazhdohej kjo politikë që mund të kishte një përmirësim të gjendjes së zbatimit të të drejtave me kalimin e kohës, por që besojmë se duhen krijuar politika të reja dhe të intensifikojmë punën e ZDA-së dhe të institucioneve tjera që merren më këtë fushë; duhen krijuar politika më novative dhe efikase për të arritur qëllimin.

# Kapitulli 3.2.: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore

Opsioni i dytë është përmirësimi i politikave aktuale dhe zbatimit dhe ekzekutimit më të mirë të legjislacionit aktual në fuqi.

Ky opsion mund të arrihet nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve njerëzore në institucionet e politikbërjes dhe ato të zbatimit të ligjit. Së pari ngritja e kapaciteteve të ZDA-se nëpërmjet trajnimeve të zyrtarëve në fushat në të cilat hasen sfidat dhe rritja e numrit të zyrtarëve; krijimi i një strukture të re të ZDA-së ku secili zyrtar do të jetë përgjegjës për një fushë të caktuar dhe do të merret më intensivisht me atë fushë. Përmes organizimit të më më shumë trajnimeve për zyrtarët e zbatimit të ligjit si për : Gjykatat; Prokurorinë; Policinë; Inspektoratin e Tregut; Doganën; dhe KPM-në.

Trajnimi i zyrtarëve të institucioneve të politik bërjes si: MD; MASHT; MIN. Trajnimi i ofruesve të shërbimeve si: Operatorët Kabllorët, Transmetuesit dhe operatorët tjerë. Disa nga trajnimet specifike që do të duhej zhvilluar janë:

1. Trajnime për zgjedhjen e rasteve nga fusha e të drejtës së autorit në mënyrë efikase dhe për marrjen e vendimeve të argumentuara;
2. Trajnim lidhur me kuptimin dhe parandalimin dhe luftimin e piratërisë;
3. Trajnimi për trajtimin e mallrave të sekuestruara dhe konfiskuara;
4. Trajnime për zyrtarët institucioneve të zbatimit të ligjit dhe të hartimit të politikave për ti vetëdijesuar lidhur me rëndësinë e të drejtave të autorit dhe të drejtat e përafërta, etj.

Për një zbatim më të mirë ZDA duhet ti jap fokus të veçantë ngritjes së vetëdijes qytetare si një nga faktorët kyç që ndikon në shkeljen e të drejtave të autorit. ZDA veçse zhvillon shumë aktivitete qëllimi i të cilave është ngritja e vetëdijes qytetare, aktivitete këto që kanë treguar rezultate pozitive por që nuk kanë pasur shtrirje të gjerë. Për tu përmirësuar situata aktuale ZDA do të duhej t'i kushtonte më shumë rëndësi ngritjes së vetëdijes duke ndërmarrë hapa konkret dhe zhvilluar fushatë më intensive, që do të mund të arrihet nëpërmjet:

1. Zhvillimi i hulumtimeve për të analizuar situatën e të drejtave të autorit në Kosovë: që do të na ndihmonte të dimë gjendjen reale në Kosovë që të mund të krijojmë politika sipas nevojave të tregut;
2. Ngritja e vetëdijes nëpërmjet materialeve të shkruara si broshura, revista etj.
3. Edukimi dhe ngritja e vetëdijes nëpërmjet ligjëratave dhe punëtorive;
4. Intensifikimi i veprimeve promovuese, si fushata, tryeza diskutimi, debate televizive, etj.
5. Zhvillimi i një kampanje në hapësirën digjitale, nëpërmjet postimeve në rrjete sociale, zhvillimit të videove informuese etj. Theks i veçantë do ti kushtohej krijimit të mundësisë që qytetarëve të Kosovës ti jepet qasje në përmbajte origjinale nga ofrues të shërbimeve në botë si Spotify, në mënyrë që qytetarët të mos kenë nevojë të shfrytëzojnë metoda ilegale për ti përdorur këto shërbime, siç është rasti i piratërisë.

6. Kampanjë vetëdijesuese për rritjen e numrit të femrave dhe të të rinjve në krijimin dhe zhvillimin e veprave origjinale.

Një sfidë aktuale që do të mund të tejkalohej nëpërmjet ekzekutimit më të mirë të legjislacionit në fuqi është funksionalizimi i menaxhimit kolektiv, më saktësisht realizimi i kompensimeve nga e drejta e autorit. Kjo do të mund të arrihej nëpërmjet caktimit të tarifave të përgjithshme për të gjithë të drejtat që shfrytëzohen, nga fusha e muzikës dhe veprave audiovizuale, e më pas të bëhej mbledhja e këtyre tarifave nga shoqata kolektive përkatëse e licencuar.

Ndonëse përmes opsionit të përmirësimi i politikave aktuale dhe zbatimit dhe ekzekutimit, përmirësimi i zbatimit dhe ulja e nivelit të shkeljeve të drejtave të autorit, mund të arrihet sukses i pjesshëm dhe kjo formë do të merrte më shumë kohë dhe do të lejonte hapësire për mëdyshje e llogaridhënie posaçërisht në menaxhimin kolektiv dhe në përcaktimin e tarifave të përgjithshme për të drejtën e autorit, do të vazhdonin problemet në realizimin e të hyrave nga e drejta e autorit, me vështirësi të theksuara në mbledhjen e kompensimeve për materialin e mbrojtur për shkak të vështirësive në miratimin e tarifave të përgjithshme. Problemi tjetër është puna e shoqatave, përmirësimi i punës së shoqatave do të mund të arrihej nëpërmjet një mbikëqyrje më efektive nga ana e ZDA-së dhe një presion të lehtë me qëllim të ngritjes së efektshmërisë së shoqatave. Problem tjetër që nuk mund të i jepet zgjidhje me këtë opsion është edhe shfrytëzimi dhe zbatimi i të drejtave të autorit në ambientin digjital që është nevojë e kohës të rregullohet dhe adresohet si çështje.

## Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë ndryshimi i kornizës aktuale legjislative

Opsioni i tretë i shqyrtuar është ndryshimi i kornizës aktuale legjislative. Ky opsion nënkupton hartimin e një ligji të ri, i cili do të rregullonte zbrazëtirat ligjore të hasura dhe do të rregullonte sfidat e reja të krijuara si rrjedhojë e zhvillimeve teknologjike të fundit. Kjo në të njëjtën kohë sillte të përafrohej legjislacioni vendor me të BE-së dhe me traktatet ndërkombëtare, të cilat janë zhvillime të fundit ligjore për të iu dhënë zgjidhje problemeve me të cilat janë ballafaquar mbajtësit e të drejtave po edhe shfrytëzuesit.

Zgjedhja e këtij opsioni do të rregullonte funksionimin e shoqatave kolektive, ku disa nga sfidat që do të rregulloheshin janë: : menaxhimi i shoqatave kolektive veçanërisht te pjesa e llogaridhënies dh transparencës së tyre, gjë që tanimë është rregulluar nga vendet anëtare të BE-së, në këtë aspekt do të transpozohen dispozitat e Direktivës 2014/26/EU për Menaxhimin Kolektiv të drejtave të autorit nga shoqata përkatëse ku nga shoqata do të kërkohej të përgatiste raporte vjetore të transparencës të cilat do të botoheshin në ueb-faqen e shoqatës dhe që raporti vjetor i transparencës do të përmbante së paku informata në lidhje me deklaratën financiare dhe për aktivitetet gjatë vitit fiskal, përfshirë këtu raportet me shoqatat tjera dhe në lidhje me shumat

e shpërndara për mbajtësit e të drejtave për secilën kategori. Kjo do të ndihmonte në funksionimin më të mirë të brendshëm të shoqatave, do të rriste besimin e krijuesve te shoqatat, do të lehtësonte arritjen e marrëveshjeve kolektive me shfrytëzuesit e të drejtave, si dhe do të lehtësonte punën e ZDA-së në mbikëqyrjen e shoqatave dhe në përgjithësi në efektivitetin e tyre. Struktura qeverisëse e Shoqatave është e përcaktuar me ligjin aktual por nuk specifikohen detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre institucioneve, se kujt i japin llogari dhe se si japin llogari. Ligji i ri do të parashihte detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e secilit institucionet, do të krijonte një sistem të bilancit të fuqive, do të përcaktonte se si duhet raportuar, se çfarë të dhëna duhet të ofrojnë, se si menaxhohen të hyrat e Shoqatës dhe se sa guxojnë të ndalen për funksionimin e shoqatës, sa për çështjet kulturore dhe pjesa e mbetur se si duhet të shpërndahet tek mbajtësit e të drejtave. Po ashtu ka rëndësi që të bëhet transparent procesi i shpërndarja e mjeteve tek mbajtësit, me qëllim të fitimit të besimit të mbajtësve të të drejtave.

Një tjetër aspekt tjetër ligjor që do të rregullohej e përmirësohej, do të ishte çështja e përcaktimit të tarifave. Ndonëse kjo çështje rregullohet në ligjin aktual, nga praktika kemi parë që ka pasur vështirësi në realizimin e saj, kjo për shkak të mënyrës se si është lënë caktimi i tarifës. Me ligjin e ri kjo do të mënjanohej, do të përcaktohet në mënyrë taksative se si duhet caktuar tarifa. Kjo do të mund të arrihej duke përdorur modelin slloven, ku krijohet një bord për përcaktimin e tarifës, bord ky i krijuar nga kreu i qeverisë pra Kryeministri, ky bord do të caktohej me mandat katër vjeçar dhe do të ishte autoriteti përgjegjës dhe kompetent për të caktuar tarifat në të gjitha fushat e të drejtës së autorit, nga lënda e shfrytëzuar nga transmetuesit televiziv e deri tek ajo shfrytëzuar nga baret, qendrat tregtare dhe format tjera të shfrytëzimit të drejtës së autorit, etj, gjithherë duke marrë parasysh kriteret në vijim si: të hyrat që mund të fitohen nga përdorimi i veprës ose të lëndës së të drejtave të përafërta; kur të ardhurat nuk e reflektojnë natyrën e përdorimit të veprave ose lëndës së të drejtave të përafërta, kostoja e përdorimit të tyre ose ndikimi në shfrytëzimin normal të tyre nga mbajtësi i të drejtës; kapacitetin i vendit ku përdoren veprat ose lënda e të drejtave të përafërta; madhësinë e publikut për të cilin janë vënë në dispozicion veprat ose lënda e të drejtave të përafërta; rëndësinë e përdorimit të veprave ose lëndës së të drejtave të përafërta për aktivitetet relevante të përdoruesve; raportin ndërmjet veprave ose lëndës së të drejtave të përafërta te mbrojtura me ato të pambrojtura.

Po ashtu do të rregullohej më mirë çështja se si do të përcaktohet shoqata e cila do të merret me menaxhimin e tarifës, qoftë kjo nëpërmjet një bashkëpunimi mes shoqatave ekzistuese, licencimi i vetëm njërës nga shoqatat kolektive, licencimi i një shoqate të tretë apo ndonjë formë tjetër. Licencimi është paraparë edhe me legjislacionin në fuqi dhe do të vazhdoj të mbetet në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku vetëm subjektet e licencuara si Shoqata kolektive do kanë mundësinë e menaxhimit kolektiv të të drejtave. Duke potencuar se licencimi i shoqatave bëhet për të lehtësuar marrjen e të drejtës për përdorim nga ana e bizneseve dhe të gjitha subjekteve të tjera që shfrytëzojnë të drejtat. Ajo që është me rëndësi, Shoqata Kolektive duhet fillimisht të themelohet dhe të përfaqësoj një numër të caktuar të mbajtësve të të drejtave për një kategori të lëndës së mbrojtur e me pas të paraqitet për licencim. Përveç përmbushjes së kritereve të themelimit dhe përfaqësimit të mbajtësve të të drejtave, dhe dëshmisë së përfaqëson mbajtës të të drejtave të kategorisë përkatëse dhe dëshmisë se mund të menaxhoj këto të drejta, shoqata nuk ka nevojë të paguaj apo të përmbush asnjë kriter tjetër administrativ. Licenca nuk është e

përcaktuar në kohë por jepet për afat të pacaktuar, e njëjta mund të merret nëse shoqata dështon të kryej misionin e saj konform statutit të saj dhe licenca mund të revokohet nga zyra për arsyeje keq menaxhimi apo abuzimi të vërtetuar. Licencimi është i domosdoshëm sepse autorizon dhe legjitimon një subjekt për të ushtruar menaxhimin kolektiv në territorin e Republikës së Kosovës.

Me ligjin e ri do të rregullohej Task Forca ku do të përcaktohej qartë detyrat dhe përgjegjësitë e saj, mandati dhe struktura e saj. Kjo do të ndihmonte në vazhdimësinë e Task Forcës, e cila përveç se ka treguar sukses po ashtu ka ndihmuar në koordinimin më të mirë në mes të institucioneve publike.

Task-Forca kundër piraterisë është paraparë të jetë një trupë koordinuese në luftën kundër piraterisë, dhe është shumë me rëndësi që Task-Forca të jetë efektive në realizmin e misionit të saj. Task-Forca do të ketë për qëllim të rritjen e bashkëpunimit në mes të institucioneve relevante inspektoratit të tregut, doganës së Kosovës dhe Policisë së Kosovës në luftimin e shkeljes së të drejtave të autorit, kjo synohet të arrihet nëpërmjet shkëmbimit të inteligjencës dhe marrjes së veprimeve. Me ligjin e ri Task-Forca do të krijojë procedurat standarde të veprimit, dhe përveç rolit bashkëpunues, informues dhe këshillues.

Ky opsion do të mund të rregullonte dhe strukturën e ZDA-së. Do të mundësonte ristrukturimin e ZDA-së sipas praktikave ndërkombëtare, gjë që do të ndihmonte në përmirësimin e punës së ZDA-së. ZDA do të kishte dy divizione atë të promovimit e edukimit dhe divizionin e menaxhimit kolektiv.

Një tjetër objektiv i ligjit të ri do të ishte rregullimi i shkeljeve të të drejtave të autorit në ambientin digjital. Si pasojë e zhvillimit teknologjik dhe numrit gjithherë e më të madh të përdoruesve të internetit, numri i shkeljeve të të drejtave të autorit në ambientin digjital ka shkuar në rritje. Ky fenomen është hasur në të gjitha shtetet. Ligji i ri do të merrte për bazë praktikat e shteteve të rajonit dhe më tej, duke shikuar mënyra sa më efikase se si do të mund të rregullohej ligjërisht kjo çështje, me qellim të parandalimit të këtyre shkeljeve por dhe të gjetjes së metodave sa më efikase të gjetjes së shkelësve dhe sanksionimit të tyre do të kishim një transpozim të plotë me Direktivën 2019/790.

Me këtë opsion do të adresohej edhe çështja e harmonizimit të plotë të legjislacionit me direktivat dhe rregulloren e BE-së nga fusha e të drejtës së autorit, të cilat do të transpozohen plotësisht me legjislacionin e ri, si në vijim: Direktiva 2014/26/EU për Menaxhimin Kolektiv të drejtave të autorit; Direktiva e BE-së 2017/1564 për lejimin e përdorimeve të caktuara për nevojat e personave verbër, me pengesa ose kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp; Rregullorja e BE-së 2017/1563 për shkëmbimin ndërkufitar për nevojat e personave që janë të verbër, me pengesa ose kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp; Rregullorja e BE-së 2017Direktiva e BE-së 2019/790 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në Tregun e Përbashkët Digjital.

Ligji i ri do të rregullonte çështjen e përdorimit të lejuar të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit për personat e verbër dhe personat me vështirësi në të shikuar, do të bënim një transpozim

të plotë të dispozitave të rregullores 2017/1563. Kjo çështje nuk është e rregulluar me ligjin aktual, dhe nuk do të mund të rregullohej me akte nënligjore. Kjo e drejtë do ti ndihmonte shumë personave të lartcekur, gjithashtu edhe në qarkullimin e librave nga vendet tjera në Republikën e Kosovës dhe do të ju mundësonte për personat e verbër dhe personat me vështirësi në të shikuar qasje në literaturë falas.

# Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Tabela më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore. Këto mjete janë të listuara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

*Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit*

| Kategoritë e ndikimeve potenciale | Opsioni 1 | Opsioni 2 | Opsioni 3 |
|---|---|---|---|
| Ndikimet ekonomike | Mund të argumentohet se me mos ndryshimin e gjendjes aktuale, tregu ilegal do të rritej më shumë, veçanërisht tregu ilegal digjital. Kjo do të ndikonte direkt negativisht në të bërit biznes në Kosovë, shumë kompani vendore dhe të huaja nuk do të mund të konkurronin në tregun e Kosovës më me përmbajte origjinale. Kjo do të ndikonte në uljen e investimeve të huaja, pasi tregu nuk do të ishte i sigurt dhe do të ndikonte në uljen e prodhimit vendor. Drejtpërdrejtë do të | Veprimet e propozuara për opsionin 2 do të kenë ndikime ekonomike. Fokusi kryesor i opsionit dy është informimi dhe ngritja e vetëdijes qytetare, realizimi i suksesshëm i këtij opsioni do të ndikonte që ndërmarrësit Kosovar të jenë më të vetëdijshëm për të drejtat e autorit, dhe si rrjedhojë do të ketë ulje të veprimtarisë ilegale për sa i përket shkeljes së të drejtave të autorit.<br>Kjo do të mund të ndikojë në rritjen e numrit të prodhuesve vendor, të cilët do të | Opsioni 3 do të ketë të gjitha ndikimet e Opsionit 2, por që ato do të jenë më të larta. Kjo për arsye se opsioni 3 po ashtu përfshin ngritjen e vetëdijes dhe pos asaj dhe ndryshime ligjore të cilat do të ndihmojnë luftimin më efikas të shkeljeve të të drejtave të autorit dhe zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë.<br>Një pikë me rëndësi ku ndryshimi i ligjit do të ndikojë është te shkelja e të drejtave të autorit në ambientin digjital, ligji i ri do të merrte për bazë praktikat ndërkombëtare dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | rritej e ekonomia jo-formale në vend. | mund të prodhojnë mallra dhe vepra origjinale dhe do të mund ti eksportonin të njëjtat.<br>Do të ndikojë në konkurrueshmëri, bizneset kosovare, duke pasur më pak mallra pirate, vakumi i krijuar do të duhej mbushur me mallra origjinale qofshin vendore apo të jashtme, gjë që do të ndikojë dhe në rritje të inovacionit dhe në ulje të çmimeve.<br>Do të ketë rritje të investimeve, një treg me më pak mallra pirate dhe tregti ilegale. Tregu do të ishte më i besueshëm, si rrjedhojë kompanitë si vendore por dhe të huaja do të jenë më të prira të investojnë në tregun e Kosovës. | veçanërisht ato të BE-së ku cekën cilat veprime konsiderohen joligjore dhe sanksionet për to.<br>Duke e rregulluar këtë fushë ligjërisht, luftimi i përmbajtjeve ilegale online do të jetë më i suksesshëm. Një veprim i tillë do të përmirësonte dukshëm tregun dhe do të krijonte të ardhura të ligjshme për mbajtësit e të drejtave por edhe vetë shfrytëzuesit. Ky opsion do të ngritë nivelin e të ardhurave nga e drejta e autorit si pjesëmarrje e përgjithshme në prodhimin e brendshëm bruto në vitet e ardhshme në Republikën e Kosovës. |
| Ndikimet shoqërore | Nuk ka/ ose njëjtë si te pjesa më lartë, rritja e tregut ilegal do të ketë dhe ndikim negativ shoqëror, njerëzit do të jenë më pak të prirë të krijojnë vepra origjinale të hapin biznese novative etj. Vazhdimi i gjendjes ekzistuese do të ndikonte negativisht në cilësinë e krijimëve | Përzgjedhja e këtij opsioni do të ketë ndikime shoqërore. Mund të themi se do të ndikohet sektori ilegal i prodhimit dhe importimit të mallrave pirate, gjë që do të ndikojë në ekonominë e vendit dhe në numrat e të punësuarave.<br>Por ky boshllëk do të mbushet nga bizneset | Opsioni 3 do të ketë të gjitha ndikimet e Opsionit 2, por që ato do të jenë më të larta. Luftimi i krimit do të jetë më i suksesshëm gjë që si rrjedhojë do të ndikojë në një nivel më të kënaqshëm të sigurisë.<br><br>Ligji i ri do të mund të parasheh mënyra të financimit të |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | intelektuale dhe do të largonte nga krijimtaria intelektuale personat që merren me këtë veprimtari, duke ndikuar kështu edhe në të ardhmen e shoqërisë tonë në aspekt të trashëgimisë kulturore pasi që krijimet e sotshme janë trashëgimia e kulturore e ardhshme kombëtare. | e reja që do të hapen dhe investitorët e huaj.<br><br>Do të ndikojë pozitivisht tek të drejtat e punëtorëve, pasi në një treg legal të rregulluar punëtorëve ju garantohen disa të drejta dhe punëdhënësit e kanë për obligim ti respektojnë.<br><br>Do të ndikojë në informimin dhe edukimin e publikut, ku nëpërmjet fushatave dhe trajnimeve qytetarët do të jenë më të informuar për çështjet të drejtës së autorit.<br><br>Do të ndikojë në rritjen e sigurisë dhe uljen e krimit në vend, pasi që në bazë të studimeve të Interpolit grupet kriminale zakonisht merren me pirateri apo tregtim të mallrave pirate. | organizatave kulturore nga mbledhja e tarifave, gjë që do të ndikonte në përmirësimin e jetës kulturore dhe krijimtarisë kulturore.<br><br>Do të ndikojë në nxitjen e krijuesve për krijimtari intelektuale nga e cila do të përfitonte shoqëria e vendit tonë në përgjithësi. |
| Ndikimet mjedisore | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka |
| Ndikimet në të drejtat themelore | Përmes opsionit të parë do të ruhet gjendja e pandryshuar në njohjen dhe realizimin e të drejtave, mbajtësit e | Ky opsion ndikon në të drejtat themelore të qytetarëve.<br>Së pari do të ketë ndikim në dinjitetin dhe integritetin njerëzor. | Ky opsion po ashtu ndikon në të drejtat themelore të qytetarëve.<br>Përveç ndikimeve të cekura në opsionin 2, në këtë opsion do të |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | të drejtave por edhe shfrytëzuesit do të realizojnë të drejtat e tyre të parapara me ligjin në fuqi, në funksion të realizmit të drejtës së tyre themelore në mbrojtjen e pronës dhe të lirisë së shprehjes e të drejtës së informimit. | Do të ndikojë në mbrojtje më të mirë të të drejtave të njeriut, veçanërisht të atyre pronësore-intelektuale të cilat janë të njohura edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në kuadër të drejtës në mbrojtjen e pronës. Përmes këtij opsioni do të ketë përmirësim të dukshëm në realizimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta. | ketë dhe ndikime shtesë pozitive.<br><br>Ndikon në një administrim më të mirë të shoqatave kolektive, ku do të ketë më shumë transparencë dhe qasje në dokumentet zyrtare të tyre, si statuti etj.<br><br>Do të ndikojë pozitivisht tek nevojat dhe të drejtat e personave të verbër, me pengesa/kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp, ku me ligjin e ri do të ju mundësohet qasje falas për ta në vepra të përcaktuara. |
| Ndikimi gjinor | Opsioni 1, nuk ka ndikime të drejtpërdrejta gjinore, për faktin që edhe ligji në fuqi nuk bënë dallime në aspektin gjinor, por i mbron të gjithë autorët njëjtë dhe pa diskriminim. Krijimet intelektuale dhe ato të cilat mbrohet për shkak të investimit me të drejtat e përafërta janë të gjitha të mbrojtura me momentin e krijimit apo të transmetimit të veprës pa asnjë dallim të bazuar në gjini. Marrë për bazë | Opsioni 2, nuk ka ndikime të drejtpërdrejta gjinore, për faktin që edhe sipas këtij opsioni nuk janë paraparë ndryshime, por ashtu si është sanksionuara me ligjin në fuqi nuk ka dallime në aspektin gjinor, të gjithë autorët trajtohen njëjtë dhe pa diskriminim. Krijimet intelektuale dhe ato të cilat mbrohet për shkak të investimit me të drejtat e përafërta, janë të gjitha të mbrojtura me | Opsioni 3, nuk ka ndikime të drejtpërdrejta gjinore, për faktin që edhe sipas këtij opsioni nuk janë paraparë ndryshime ligjore që mund të rrezikonin në ndonjë mënyrë të mundshme barazinë gjinore të paraparë me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit. Mund të argumentohet se fokus i ZDA-së do të jetë dhe stimulimi i gjinisë femërore më të madhe në fushën e krijimtarisë, gjë që do të ndikonte në një |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | faktin që të drejtat që burojnë nga e drejta e autorit dhe nga të drejtat e përafërta janë të drejta që vijnë në shprehje pas krijimit të veprës, bazuar në ligjin për të drejtën e autorit në fuqi.<br>Veprat janë të mbrojtura, autorët pa dallim gjinie gëzojnë të drejtat e tyre, në këtë aspekt gratë dhe burrat janë të barabartë si në aspektin e të drejtave që gëzojnë si në aspektin e mjeteve juridike që mund ti përdorin për mbrojtjen e të drejtave të tyre. E drejta e autorit është e sanksionuar edhe me kushtetutën e vendit në kuadër të drejtave pronësore dhe mbrojta që jepet për autorët është pa asnjë dallim në aspektin gjinor. | momentin e krijimit apo të transmetimit të veprës pa dallim të bazuar në gjini.<br>Mund të argumentohet, se sipas opsionit 2, fokus i ZDA-së do të jetë dhe stimulimi i gjinisë femërore në pjesëmarrje më të madhe në fushën e krijimtarisë, gjë që do të ndikonte në një përfaqësim më të madh të tyre në sektorin e të drejtës së autorit dhe krijimtarinë intelektuale në përgjithësi. | përfaqësim më të madh të tyre në këtë sektor.<br>Edhe pse simulimi dhe subvencionimi është politikë e Departamentit të Kulturës në Kuadër të MKRS-së. |
| Ndikimet e barazisë sociale | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka |
| Ndikimet tek të rinjtë | Nuk ka | Nuk ka | Ndikimi tek të rinjtë është kryesisht në aspektin që kur të drejta e autorit zbatohen më mirë në shtetin tonë dhe funksionon menaxhimi kolektiv ku autorët do të marrin të hyra, kjo do |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | të ndikoj tek një pjesë e të rinjve pasi që ata do të shohin që nëse krijojnë dhe veprojnë, për veprat e tyre do të marrin kompensime monetare dhe kjo mund të jetë një nxitje që më shumë të rinj të krijojnë dhe të merren me kreativitet. Ndikimi pra do të jetë më shumë të rinj të përfshirë në krijimin e veprave të autorit. |
| Ndikimet në ngarkesën administrative | Nuk do te ketë ngarkesë administrative. | Nuk do te ketë ngarkesë administrative. | Nuk do te ketë ngarkesë administrative. |
| Ndikimi i NMV-ve | Opsioni 1, pa ndryshuar gjendjen ekzistuese nuk ka përmirësim të zbatimit të drejtave të autorit dhe të drejtat e përafërta atëherë nuk ka edhe përfitime nga e drejta e autorit për ndërmarrjet e mesme apo të vogla, grup ky i ndërmarrjeve që mund të përfitojnë nga mbrojta me të drejtën e autorit për produktet e tyre.<br>Në bazë të studimeve të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, ndërmarrjet e mesme dhe të vogla janë ato të cilat mund të përdorin të drejtat pronësore intelektuale për të u zhvilluar dhe për të rritur biznesin e tyre. | Opsioni 2, përkatësisht duke bërë një zbatim më të mira të rregullave ekzistuese, do të sillte patjetër përmirësime për ndërmarrjet e mesme dhe të vogla pasi që në këtë kategori të ndërmarrjeve është kapaciteti krijues dhe novativ.<br>NMV-të do të përfitonin nga ky opsion pasi që me përmirësim të vetëdijesimit të tyre, ato do të përdornin të drejtën e autorit për të mbrojtur krijimtarinë e tyre që mbrohet me të drejtën e autorit nga produktet, video-reklamat që i bëjnë për produktet e tyre dhe apo për broshurat e | Opsioni 3, do të kishte ndikimet e njëjta me opsionin 2, përveç se NMV-të si rezultat i funksionimit të menaxhimit kolektiv më të mirë do të kishin mundësi të futeshin më lehtë në marrëveshje dhe siguronin licenca për prodhimin eventual të produkteve bazuar në krijimet e mbrojtura të personave të tretë, që pa një menaxhim kolektiv funksional në praktikë është paraqit shumë vështirë të realizohet.<br>Do të rritej siguria juridike e të bërit biznes për NMV, me materialin e mbrojtur me të drejtën e autorit në ambientin digjital, si rezultat i |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | NMV-të janë më të suksesshme në shitjen e produkteve të tyre nëse kanë të drejtat e tyre nga pronësia intelektuale të llogaritura në kuadër të aseteve të tyre të përgjithshme. | ndryshme të cilat mbrohen me të drejtën e autorit. Qasja e ndryshuar e zbatimit do të ndikonte në përmirësimin e të bërit biznes dhe në rritjen edhe të sigurisë juridike për NMV, pasi që me një vetëdijesim më të mirë ato do të dinin obligimet e tyre karshi të drejtës së autorit, të mbroheshin nga paditë eventuale dhe mund të siguronin licenca për të prodhuar produkte të caktuara të cilat janë të mbrojtura me të drejtën e autorit dhe të rrisnin edhe qarkullimin e tyre tregtar. | ndryshimeve ligjore që do të bëhen në legjislacionin. Do të paraqiten subjekte-NMV të cilat mund të merreshin me prodhimin e materialeve që mbrohen me të drejtën e autorit në dobi të personave të verbër, me pengesa/kufizime në shikim apo kufizime tjera në shtyp, ku me ligjin e ri do të ju mundësohet qasje falas për ta në vepra të mbrojtura. |

# Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Mbledhja e të dhënave ka qenë mjaft sfiduese, kjo për disa arsye. Në Kosovë nuk gjenden statistika në lidhje me sistemin e së drejtës së autorit, dhe ZDA deri më tani nuk ka pasur kapacitetin financiar që të zhvillojë një hulumtim të thellë. Ende nuk është bërë një studim i përgjithshëm i vlerës së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta për ekonominë e vendin tonë apo në pjesëmarrja e përgjithshme e të drejtës së autorit në prodhimin e brendshëm bruto të vendit tonë.

Një tjetër arsye është mos interesimi i palëve të interesit dhe qytetarëve. Gjatë takimeve publike numri i palëve që kanë marrë pjesë ka qenë tejet i ulët ndonëse kanë qenë të njoftuar shumë kohë më parë, po ashtu më pas janë kontaktuar nëpërmjet e-mailit dhe prapë ka pasur interesim të

vogël. Për mbledhjen e të dhënave nga qytetarët kemi krijuar një pyetësor online dhe e kemi shpërndarë në rrjete sociale, por dhe aty nuk kemi arritur të mbledhim shumë të dhëna.

Pavarësisht këtyre sfidave ZDA dhe grupi punues ka arritur që të bëj mbledhjen e të dhënave nëpërmjet diskutimeve, takimeve dhe bazuar në ankesat e pranuara për sa i përket pengesave që qytetarët apo kompanitë kanë hasur në implementimin e legjislacionit aktual, si dhe bazuar në punën vazhdueshme me palët e interesit përgjatë viteve nga ana e ZDA-së përgjatë trajnimeve dhe ngjarjeve të organizuara nga viti 2012 e deri më tani si dhe nga përvoja e zyrtarëve përgjegjës përgjatë implementimit të Ligjit aktual në fuqi.

# Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Nga takimet e mbajtura me palët e interesit është identifikuar nevoja për marrjen e masave në ndryshimin dhe zhvillimin e sistemit të drejtës së autorit. Në të gjitha forumet me palët e internisti, si me në ato në kuadër të institucioneve shtetërore Task Forcës Kundër Piraterisë, Këshillit Kombëtar për Pronësi Intelektuale, në forumet me mbajtës të të drejtave dhe shfrytëzues, përfshirë në forumet në kuadër të takimeve me përfaqësues të BE-së është paraqitur nevoja dhe kërkesa për ndryshme.

Palët e kontaktuara kanë qenë: Shoqatat Kolektive (VAPIK dhe APIK); Institucionet Shtetërore relevante (Prokuroria, Gjyqësori; Policia - Departamenti i krimeve ekonomike dhe Departamenti i krimeve kibernetike; Dogana; Këshilli i Pavarur i Medieve; Inspektorati i Tregut; Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Zyra e Kryeministrit etj;) Bizneset në Kosovë (operatorët kabllorë, ofruesit e shërbimeve të internetit, shtëpitë botuese etj), Palët tjera (Shoqëria Civile; Odat Ekonomike etj.) dhe qytetarët e thjeshtë dhe mbajtësit e të drejtave.

Palët e sipër përmendura janë ftuar në diskutime publike, ku janë mbajtur 3 diskutime publike për të gjitha palët e interesit. Ftesa për të marrë pjesë iu është dërguar një numri të madh të palëve, nga të cilat vetëm një numër modest kanë marr pjesë në këto takime, sidomos tek palët e sektorit privat.

Në fazat e ardhshme të kompletimit të draftit do të vazhdohet sipas procedurave të parapara më qëllim që të mblidhen sa më shumë informata relevante, përfshirë këtu përmes pranimit të komenteve nga palët e interesit në konsultimet publike të parapara dhe nga institucionet përkatëse shtetërore.

*Figura 7: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument*

Procesi i konsultimit synon: Të mblidhen sa më shumë informata relevante, përfshirë këtu përmes pranimit të komenteve nga palët e interesit dhe nga institucionet përkatëse shtetërore në lidhje me problemet dhe sfidat që ato i hasin në lidhje me fushën e të drejtës së autorit në vendin tonë.
Në konsultimet e mbajtura publike janë njoftuar palët lidhur me qëllimin e hartimit të Koncept Dokumentit dhe u është kërkuar paraqitja e qëndrimeve të tyre. Palët nuk kanë paraqitur komente në takimet publike të mbajtura në datat e paraqitura në tabelë.

Në Konsultimet ndërministrore janë paraqitur komente nga ana e përfaqësuesve të Sekretariatit të Qeverisë dhe të Zyrës Ligjore të Kryeministrit të cilat komente janë marrë parasysh dhe janë bërë pjesë e këtij koncept dokumenti.

- [Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, kolona për buxhet duhet të fshihet.]
-

| Qëllimi kryesor | Grupi i synuar | Aktiviteti | Komunikimi/njoftimi | Afati kohor | Buxheti i nevojshëm | Personi përgjegjës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Takimi i hapur për të gjithë palët e interesuara per t'i informuar palët e intereit | Të gjitha palët e interesuara: Institucionet Shtetërore: Dogana, KPM, Asosacionin e Komunave<br><br>Shoqatat Kolektive | Takime publike | Takim Publik<br><br>Publikimi ne ueb-faqe të MKRS dhe te ZDA-se<br><br>Publikimi ne rrjete sociale te MKRS dhe ZDA<br><br>Me email | 29 Maj 2019<br><br>10 deri 21 Qershor 209<br><br>10 deri 21 Qershor 209<br><br>21 Gusht 2020 | 250 euro | Udhëheqësi i Grupit Punues |
| Bashkëpunim dhe Diskutim ne lidhje me Draft KD me | Të gjitha palët e interesuara | Katër takime te veçanta me palët e interesit | E-mail<br><br>Telefon | 29 Maj 2019<br><br>6 dhe 7 Qershor 2019 | 1,000 euro | Udhëheqësi i Grupit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| pale te interesit | | | | | | |
| Konsultimi Ndërinstitucional me përfaqësuesit në kuadër të Task Forcës kundër Piraterisë | Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit, Inspektorati i Tregut, Ministria e drejtësisë, Agjencia për Pronësi Industriale, Përfaqësuesit e Këshillit Shtetëror të Pronësisë intelektuale | Takime të vazhdueshme të Task Forcës kundër Piraterisë | Takime dhe komunikim me email dhe telefon | 14 Qershor 2020<br>7 Gusht 2020<br>dhe<br>20 Dhjetor 2019 | 1300 euro | Udhëheqësi i Grupit |
| Konsultimi Ndërministror | Institucionet relevante te parapara ne nenin 7 | Dërgimi i materialit me e-mail | E-mail | 24 Tetor deri me 13 Nëntor 2019 | 0 euro | Udhëheqësi i Grupit dhe Departamenti ligjor |
| Takime të veçanta shtese me Fokus Grupe | Fokus Grupet:<br><br>Operatorët Kabllorë, Botuesit<br><br>Shoqëria Civile Institucionet Shtetërore relevante | Takime te veçanta me secilin fokus grup | E-mail | 6 dhe 7 Qershor 2019 | 1,000 euro | Udhëheqësi i Grupit |
| Diskutim publik | Te gjithë te | Takim Publik | Takim | Mars 2020, i | 0 euro | Udhëheqësi i Grupit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | interesuarit | | | planifikuar takimi nuk është mbajtur shkaku i pandemisë presim komentet në diskutime publike dhe koncept dokumenti do të dërgohet me email. | | |
| Konsultim Online me shkrim | Te gjitha palat e interesit | Publikimi i Draftit ne Platformën Digjitale | uebsite<br><br>Rrjete Sociale | 29 Gusht 2020 ose shtator (varësisht nga përkthimi) | 0 euro | Udhëheqësi i Grupit |
| Konsultim me ekspertë ndërkombëtar në të projektit të BE-së për të Drejtat Pronësore Intelektuale | Ekspertë të drejtës së autorit – z. Ioannis Kikkis | Shkëmbim informacioni me email;<br><br>Pranim i komentev e Bisedë me Skype<br><br>Shkëmbim informacioni me email dhe pranim i | Komunikim me email<br><br>Bisede përmes Skype lidhur me çështjet kryesore<br><br>Komunikim me email | 27 Prill 2020<br><br>15 Qershor 2020<br><br>7 Gusht 2020 | Mbështetje e BE-së<br><br>Mbështetje e BE-së<br><br>Mbështetje e BE-së | Udhëheqësi i Grupit<br><br>Udhëheqësi i Grupit<br><br>Udhëheqësi i Grupit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | komentev e | | | | |

# Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Më tutje do të shtjellohen planet e zbatimit për dy opsionet të cilat vlerësohen se do të kenë ndikim real andaj dhe kanë nevojë për një plan të zbatimit.

## Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Opsioni i dytë është përmirësimi i politikave aktuale të zbatimit dhe ekzekutimit më të mirë të legjislacionit aktual në fuqi. Ky opsion do të ndihmonte në uljen e shkeljeve të të drejtave të autorit, kryesisht nëpërmjet ngritjes së vetëdijes së qytetarëve nëpërmjet fushatave vetëdijesuese dhe nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve shtetërorë kompetent, nëpërmjet trajnimit të tyre në fushat ku hasen ngecjet kryesore. Përmes këtij opsioni do të arrihet të adresohen një varg i problemeve të identifikuara dhe do të arrihej një zbatim më i mirë i legjislacionit në fuqi.

*Figura 8: Plani i zbatimit për Opsionin 2*

| Qëllimi i politikës | Respektimi dhe Avancimi i të Drejtave të Autorit | | | | | | | | Shifra e pritshme e kostos |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Objektivi strategjik | Promovimi, edukimi dhe rritja e respektit për të Drejtën e Autorit | | | | | | | | |
| | Produkti, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | Viti 1 2021 | Viti 2 2022 | Viti 3 2023 | Viti 4 2024 | Viti 5 2025 | Institucioni /departam enti përgjegjës | |
| Objektivi - specifik 1 Edukimi dhe ngritja e vetëdijes nëpërmjet | Produkti 1.1. Një vizitë studimore e realizuar; | Aktivit eti 1.1. Vizita Studim ore | | x | | | X | ZDA/MK RS | 8,000 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| edukimit formal dhe joformal | studimore e realizuar;<br><br>Produkti 1.2. Një trajnim i organizuar për gjyqtarë | Aktiviteti 1.2 Organizimi i Trajnimeve | | x | x | x | x | ZDA/MKRS, Akademia e Drejtësisë – për prokurorë dhe gjyqtarë | 6000 |
| Objektivi specifik 2 Promovimi nëpërmjet fushatave vetëdijesuese (platforma online, TV me synim rritjen e interaktivitetit ) | Produkti 1.3. Dy ligjërata të mbajtura | Aktiviteti 1.3. Ligjërata në fakultetet e drejtësisë | | x | x | x | x | | 5,000 |
| | | | | | | | | | |
| | | | Viti 1 2021 | Viti 2 2022 | Viti 3 2023 | Viti 4 2024 | Viti 5 2025 | Institucioni /departamenti përgjegjës | |
| Objektivi specifik 3<br><br>Inkurajimi i mbajtësve te te drejtave për krijimin e shoqatave te autoreve; | Produkti **2.1**. Një fushatë e hartuar | Aktiviteti 1.2.1 Hartimi i Fushatës vetëdijesuese | | x | | | | ZDA | 500 |
| | Produkti **2.2.** Fushata e realizuar në tre vite vazhdimisht | Aktiviteti 1.2.2 Implementimi i Fushatës | | | x | x | x | ZDA | 40,000 |
| | Produkti 2.3. Takimet e mbajtura me Shoqatat kolektive | Aktiviteti 1.3.1 Takimet e Rregullta me | x | x | x | x | x | ZDA | 2,000 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shoqatat | | | | | | | |
| | Produkti 2.4 Inkurajimi i mbajtësve të të drejtave për mbrojtje te të drejtave; | Aktiviteti 1.4.1 Takime te Rregullta me Mbajtjes të të Drejtave | x | x | x | x | x | | 4,000 |
| | Produkti 1.5 Inkurajimi i mbajtësve për të ofruar përmbajtje të ligjshme; | Aktiviteti 1.5.1 Takime te Rregullta me Ofruesit e Shërbimeve | x | x | x | x | x | | 4,000 |

Opsioni i tretë është ndryshimi i kornizës aktuale legjislative, ky opsion do të ndihmonte dukshëm në uljen e shkeljeve të të drejtave të autorit, do të ndihmonte në mbushjen e zbrazëtirave ligjore të hasura si dhe në avancimin e kornizës ligjore sipas nevojave të grupeve të margjinalizuara dhe nevojave të shfaqura si rezultat i avancimeve teknologjike.

Këto ndryshime do të arrihen nëpërmjet fushatave vetëdijesuese, trajnimeve të zyrtarëve; zbrazëtirat ligjore të hasura do të rregulloheshin me ligjin e ri; si dhe do të nxjerrën dispozita të reja të cilat rregullojnë çështjen e personave me vështirësi në shikim, dhe dispozita të cilat rregullojnë çështjen e piratërisë kibernetike dhe çështjet e tjera përmes dispozitave për rregullimin e të drejtës së autorit në epokën digjitale.

*Figura 9: Plani i zbatimit për Opsionin 3*

| | | | |
|---|---|---|---|
| Qëllimi i politikës | **Respektimi dhe Avancimi i të Drejtave të Autorit** | | Shifra e kostos së pritur |
| Objektivi strategjik | **Avancimi i kornizës të përgjithshme të të drejtave të autorit** | | |
| | Produkti, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës | | |
| Objektivi Specifik1 | | Ligji xx/xx për te drejtat e autorit dhe te drejtat e përafërta | |

| | | | Viti 1 2020 | Viti 2 2021 | Viti 3 2022 | Viti 4 2023 | Viti 5 2024 | Institucioni përgjegjës | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Hartimi i Legjislacionit primar dhe sekondar | Produkti 1.1.1. Grupi punues i themeluar. | Aktiviteti 1.1.Themelimi i Grupit punues | | x | | | | ZDA | 500.00 |
| | Produkti 1.1.2. Konsultimet e pwrfunduara | Aktiviteti 1.1.2. Organizmi i të gjitha Konsultimeve Aktiviteti | | x | | | | ZDA | 4,000.00 |
| | Produkti 1.1.3. Ligji i hartuar dhe i miratuar nga Qeveria | Aktivitet 1.1.3. Hartimi dhe Miratimi i Ligjit | | | x | x | | ZDA | 3,000.00 |
| | | Nxjerrja e akteve nënligjore | | | | | | | |
| | | | Viti 1 2020 | Viti 2 2021 | Viti 3 2022 | Viti 4 2023 | Viti 5 2024 | Institucioni përgjegjës | |
| | Produkti 1.2.1. Grupet punues e të themeluara | Aktiviteti 1.2.1 Themelimi i Grupit punues | | | x | | | ZDA | 500 |
| | Produkti 1.2.2. Aktet | Aktiviteti 1.2.2 Hartimi dhe Miratimi i | | | x | x | x | ZDA | 6,000 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | nënligjore të hartuara dhe të miratuara | Akteve Sekondare | | | | | | | |
| | | | Viti 1 2020 | Viti 2 2021 | Viti 3 2022 | Viti 4 2023 | Viti 5 2024 | Institucioni përgjegjës | |
| Objektivi specifik 2 Rritja e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për Sistemin Kombëtar të të Drejtave të Autorit | Produkti 2.1. Trajnimet e mbajtura | Aktiviteti 2.1. Trajnimi i Zyrtareve relevantë në fusha të ndryshme që rrjedhin nga Ligji i ri | | | x | x | x | ZDA | 8,000 |
| | Produkti 2.2. Rritja e numrit të zyrtarëve në ZDA sipas planit buxhetor të miratuar – jo planifikime shtesë | Aktiviteti 1.3.2 Rritja e numrit të zyrtarëve në institucione dhe përcaktimi i njësive përkatëse për të Drejtën e të Drejtës së Autorit | | x | x | x | | ZDA | 42,000 |
| | | | Viti 1 2020 | Viti 2 2021 | Viti 3 2022 | Viti 4 2023 | Viti 5 2024 | Institucioni përgjegjës | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Objektivi 2: Promovimi, edukimi dhe rritja e respektit për të Drejtën e Autorit | Produkti 2.1. | Aktiviteti 2.1. Edukimi dhe ngritja e vetëdijes nëpërmjet edukimit formal dhe joformal | | x | | | | ZDA | |
| | Produkti 2.2. Fushata vetëdijesuese e realizuar për çdo vit pas miratimit të politikës së re | Aktiviteti 2.2. Promovimi nëpërmjet fushatave vetëdijesuese (platforma online, TV me synim rritjen e interaktivitetit ) | | x | x | x | x | ZDA | 40,000 |
| | Produkti 2.3. Takimet e mbajtura me Shoqatat kolektive | Aktiviteti 2.3. Inkurajimi i mbajtësve të të drejtave për krijimin e shoqatave te autoreve; | | x | x | x | x | ZDA | 8000 |
| | Produkti 2.4. Inkurajimi i mbajtësve të të drejtave për | Aktiviteti 2.4. Inkurajimi i mbajtësve të të drejtave për | | x | x | x | x | ZDA | 4000 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | mbrojtje te të drejtave; | mbrojtje të të drejtave; | | | | | | | |
| | Produkti 2.5. Takime me mbajtësit e të drejtave dhe këshillim; | Aktivitet 2.5: Inkurajimi i mbajtësve për të ofruar përmbajtje të ligjshme; | | x | x | x | x | ZDA | 4000 |
| | | | Viti 1 2020 | Viti 2 2021 | Viti 3 2022 | Viti 4 2023 | Viti 5 2024 | Institucioni përgjegjës | |
| **Objektivi 2**<br><br>**Përmirësimin e bashkëpunimit në mes të palëve të interesit** | Produkti 3.1. Mbajtae takimeve të rregullta dhe aksionete realizuara | Aktiviteti<br><br>3.1: Ngritja e efikasitetit dhe të efektivitetit të Task Forcës kundër piraterisë | | | | | | ZDA | |
| | | Aktiviteti | | | | | | ZDA | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Produkti 3.2. Forume e takime të përbashkëta të mbajtura | 3.2: Krijimi i forumeve të përbashkëta me bartësve të të drejtave SHMK-të dhe përdoruesit | | | | | | | | |

## Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

Për të adresuar problematikën janë konsideruar tre opsione:

Opsioni i parë, pa ndryshime, pra do të vazhdohej me politikat aktuale dhe me zbatimin e legjislacionin në fuqi, ku si rrjedhojë do të vazhdonin ngecjet në zbatimin e të drejtave të autorit si dhe në zhvillimin e sistemit të të Drejtës së Autorit.

Opsioni përmes përmirësimit të politikave aktuale dhe zbatimit dhe ekzekutimit më të mirë të legjislacionit aktual në fuqi, mund të arrihet vetëm sukses i pjesshëm dhe kjo formë do të merrte më shumë kohë dhe do të lejonte hapësire për mëdyshje në llogaridhënie posaçërisht në menaxhimin kolektiv dhe në përcaktimin e tarifave të përgjithshme për të drejtën e autorit, do të vazhdonin problemet në zbatimin e të drejtave në ambientin digjital. Opsioni i tretë, me ndryshime legjislative përmes së cilit do të plotësoheshin zbrazëtirat lidhore dhe të rregullohej çështja e përcaktimit të tarifave të përgjithshme, si dhe përdorimi i veprave të autorit në ambientin digjital.

Duke pas parasysh që Opsioni 3, adreson problemet e paraqitura dhe u jep zgjidhje ligjore çështjeve të parregulluara, si dhe duke marr në konsideratë që nga ky opsion derivojnë përfitimet më të mëdha dhe për të cilin nuk ka kosto shtesë buxhetore, ky opsion është parë si më i duhuri dhe i rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës.

*Figura 8: Krahasimi i opsioneve*

| **Mjeti i krahasimit: Analiza shumë kritershe** | | | |
|---|---|---|---|
| **Ndikimet relevante pozitive** | Opsioni 1: Asnjë ndryshim | Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit | Opsioni 3: Ndryshimi i Kornizës Ligjore |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Nuk do të ketë ndikime pozitive, do | Mund të ketë ndikime pozitive , mirëpo opsioni do të jetë i kufizuar ngase mund të ndikojë kryesisht në përmirësimin e zbatimit të drejtave të autorit dhe ngritjen e respektit për të drejtën e autorit në shoqërinë tonë. | Opsioni do të adresoj shkaqet dhe efektet e problemit që ka penguar zbatimin e të drejtave të autorit |
| Ngritja e vetëdijes qytetare për të drejtat e autorit | | Ngritja e vetëdijes qytetare përmes fushatave vetëdijesuese | Ngritja e vetëdijes qytetare |
| Ngritja e kapacitet eve njerëzore për zbatimin e të drejtës së autorit | | Ngritja e kapaciteteve njerëzore në institucionet publike nëpërmjet trajnimeve dhe rritjes së numrit të zyrtarëve. | Ngritja e kapaciteteve njerëzore në institucionet publike nëpërmjet trajnimeve dhe rritjes së numrit të zyrtarëve |
| Sistem efikas i menaxhi mit kolektiv | | Përmirësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit kolektiv. | Rregullimi me optimal i funksionimit të sistemit të menaxhimit kolektiv |
| Task Forcë funksiona le | | | Do të rregullohej funksionimi i Task Forcës dhe përbërja do të përcaktohej me ligj. |
| Përcakti m i tarifave | | | Do të rregullohej me mire mënyra e përcaktimit të tarifave, që mos të shkaktoje sfida në të ardhmen. |
| Ngritja e kapacitet eve institucio nale për zbatimin e të | | | Do të rregullohej struktura e ZDA-së dhe do te rritej numri i zyrtareve. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| drejtës së autorit | | | |
| Respektimi i të drejtave të autorit në ambientin digjital | | | Aprovimi i dispozitave që rregullojnë parandalimin dhe luftimin e shkeljeve të drejtave e autorit në ambientin digjital |
| Plotësimi i nevojave dhe të drejtave të personave të verbër dhe personave me vështirësi në shikim | | | Aprovimi i dispozitave që rregullojnë çështjen e përdorimit të veprave për personat e verbër dhe personat me vështirësi në shikim |
| Nxitja e të rinjve të krijojnë dhe të merren me kreativitet. | | | Mbrojtja më e mirë që do të sigurohet me dispozitat e reja, do të ndikojë në nxitjen e të rinjve të krijojnë dhe të merren me kreativitet. |
| Rritja e kapacitetit krijues dhe novativ të NVM-ve dhe sigurisë së tyre juridike | | | Përcaktimi i saktë me ligj i përjashtimeve do të ndikon në rritjen e sigurisë juridike për të gjitha subjektet, përfshirë edhe për NVM-të. |
| Përcaktimi i saktë me ligj i përjashtimeve dhe | | | Përfarimi dhe harmonizimi me Legjislacionin e BE-se dhe praktikat ndërkombëtare |

<table>
<tr><td>rregullimit të mundësisë së nxjerrjes së të dhënave dhe tekstit do të ndikon në rritjen e sigurisë juridike për të gjitha subjektet, dhe do të mundësonte shfrytëzim më të mirë të materialit të mbrojtur me të drejtën e autorit.</td><td colspan="3"></td><td colspan="3"></td><td colspan="3"></td></tr>
<tr><td>Ndikimet relevante negative</td><td colspan="3">Mos përmirësimi i gjendjes aktuale</td><td colspan="3">Përmirësimi i pjesshëm i gjendjes aktuale, duke lënë te parregulluara disa çështje (qe përmenden ne opsionin 3)</td><td colspan="3">Nuk ka kosto shtesë pasi që aktivitet do të të zhvillohen sipas aspekteve buxhetore të parapara.</td></tr>
<tr><td>Kostot relevante</td><td colspan="3">Nuk ka kosto shtesë, njëjtë siç është paraparë me buxhetin aktual të ZDA-së</td><td colspan="3">Kosto shtesë për realizimin e një fushate vetëdijesuese më intensive dhe trajnimin më intensiv të zyrtarëve dhe rritjen e numrit të zyrtarëve në ZDA</td><td colspan="3">Hartimin e ligjit të ri, dhe akteve nënligjore.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Vlerësim i i ndikimit të pritshëm buxhetor</td><td>Viti 1 2021</td><td>Viti 2</td><td>Viti 3</td><td>Viti 1</td><td>Viti 2</td><td>Viti 3</td><td>Viti 1</td><td>Viti 2</td><td>Viti 3</td></tr>
<tr><td>Pagat (punëtoreve) + shpenzimet e</td><td>Nuk ka ndryshim</td><td>Nuk ka ndryshim</td><td>Pagat (punëtorëve) + ekstra shpenzime për</td><td>Nuk ka ndryshim</td><td>Nuk ka ndryshim</td><td>Pagat e punëtoreve (rritje e stafit), vetëm</td><td>Nuk ka ndryshim</td><td>Nuk ka ndryshim</td></tr>
</table>

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | promovimit<br>Pa kosto ekstra | | | promovim | | | shpenzime për promovim të cilat janë të parapara me kodin buxhetor të ZDA-së. | | |
| **Përfundimi** | Nuk ka përfitime. | | | Ofron zgjidhje parciale të problemeve pa ofruar zgjidhje adekuate. | | | Ofron përfitime më të mëdha pa kosto shtesë vetëm sipas planifikimeve buxhetore. | | |

# Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

*Figura 9: Plani i zbatimit të opsionit të preferuar*

Nga mbledhja e të dhënave dhe analiza e tyre e zhvilluar përgjatë hartimit të këtij koncept dokumenti, grupi punues ka ardhur në përfundim se opsioni që do të kishte ndikim më të madh pozitiv, është Opsioni 3- Ndryshimi i Kornizës Aktuale Legjislative. Bazuar në këtë ZDA si propozues i këtij Koncept Dokumenti i rekomandon Qeverisë së Kosovës të miratojë Opsionin 3 Ndryshimin e kornizës aktuale legjislative, opsion ky i cili parasheh hartimin e një Ligji të ri për të drejtat e autorit i cili do të shfuqizonte Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe Ligjin Nr. 05/L -047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta si dhe Ligjin . Opsion ky i cili ka për qëllim adresimin e problemit kryesor që është evidentuar pra uljen e shkeljeve të të drejtave të autorit, por dhe rregullimin dhe plotësimin e kornizës ligjore sipas nevojave aktuale.

Ky opsion rekomandohet për disa arsye të cilat janë përmendur dhe në Kapitullin 3, aty shihet qartë se ky opsion ofron zgjedhjen më adekuate për problemet që janë hasur në praktikë por dhe rregullon çështje të cilat nuk janë të rregulluara me Ligjin aktual. Ligji i ri do të rregullonte saktë çështjen e funksionimit të Shoqatave Kolektive, se si do të përcaktoheshin tarifat dhe kush do të i përcaktonte; do të rregullohej statusi i Task- Forcës kundër Piratërisë; do të përcaktohej struktura e ZDA-së me synim të krijimit të një strukture sa më efikase sipas standardeve ndërkombëtare.

Më pas Ligji i ri do të përcaktonte rregulla për çështje të cilat nuk janë parapare në Ligjin aktual, do të rregullohej çështja e përdorimit të veprave për personat e verbër dhe me vështirësi në të shikuar- ku do të lejohej qasja falas në literaturë për këta persona; po ashtu do të tentohej të

rregullohet çështja e shkeljeve të të drejtave të autorit në sferën digjitale dhe nga teknologji të ndryshme- ku për shkak të zhvillimit teknologjik të vazhdueshëm gjithmonë paraqiten mënyra të reja të shkeljeve të të drejtave të autorit, dhe kërkohet nga shteti të veprojë shpejt që të rregulloj këto çështje.

Këto çështje do të mund të rregulloheshin vetëm nëpërmjet një ligji të ri. Çështjet tjera të përmendura, si vetëdija qytetare mund të rregullohen nëpërmjet fushatave vetëdijesuese, diskutimeve dhe trajnimeve, veprime këto që janë të parapara nga ZDA dhe nuk ka nevojë të bëhen ndryshime ligjore, vetëm kërkohet një intensifikim i punës dhe me ligjin e ri do të kërkohet dhe diskutime, trajnime dhe fushata për çështjet e reja si luftimi i shkeljeve online.

Zgjedhja e Opsionit 3, nuk paraqet kosto shtesë financiare për MKRS, kjo për arsye se tanimë ZDA ka paraparë veprimet e nevojshme që do të ndërmerreshin me përzgjedhjen e këtij opsioni në Strategjinë për Forcimin e Sistemit të së Drejtës së Autorit 2019-2023, dokument ky tanimë i miratuar me të gjitha kostot e parapara.

ZDA rekomandon që Qeveria e Republikës së Kosovës të përcaktohet për Opsionin 3 të këtij Koncept Dokumenti, dhe të miratohet brenda këtij viti kalendarik në mënyrë që sa më parë të formohet grupi punues dhe të fillohet të punohet në hartimin e Ligjit të ri.

## Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Pas miratimit të këtij Koncept Dokumenti, do të formohet grupi punues për hartimin e projektligjit që do të zhvillohet përgjatë vitit 2020, dhe pritet të miratohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës në fund të po të njëjtit vit. Ligji përshihet të miratohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës në fillim të vitit 2021. Më pas përgjatë vitit pasues, ZDA si iniciues i këtij Ligji do të jetë përgjegjëse për të monitoruar dhe vlerësuar implementimin e këtij Ligji në praktikë. Periudha vlerësuese do të fillojë në vitin 2021, dhe do të zgjasë sipas nevojës.

## Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

| **Kategoria e ndikimeve ekonomike** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Vendet e punës[3] | A do të rritet numri aktual i vendeve të punës? | | Jo | | | |
| | A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës? | | Jo | | | |
| | A do të ndikojë në nivelin e pagesës? | | Jo | | | |
| | A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës? | | Jo | | | |
| Bërja e biznesit | A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes? | | Jo | | | |
| | A do të largohen nga tregu produkte të caktuara? | x | | mesatar | I lartë | I lartë |
| | A do të lejohen në treg produkte të caktuara? | x | | I lartë | I lartë | I lartë |
| | A do të detyrohen bizneset të mbyllen? | X | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A do të krijohen biznese të reja? | X | | I ulët | I ulët | I ulët |
| Ngarkesa administrative | A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja? | | X | | | |
| | A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset? | x | | I Lartë | I lartë | I lartë |
| Tregtia | A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit? | | X | | | |
| | A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit? | x | | i ulët | I ulët | I ulët |

[3] Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Transporti | A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra? | | X | | | |
| Investimet | A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja? | x | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet? | | x | | | |
| | A do të rriten investimet nga diaspora? | x | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A do të zvogëlohen investimet nga diaspora? | | X | | | |
| | A do të rriten investimet e huaja direkte? | x | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte? | | X | | | |
| Konkurrueshmëria | A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike? | x | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike? | | X | | | |
| | A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi? | x | | Mesatare | Mesatare | Mesatare |
| | A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen? | | X | | | |
| Ndikimi në NVM | A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM? | X | | Mesatare | Mesatare | Mesatare |
| Çmimet dhe konkurrenca | A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët? | X | | I ulët | I ulët | I ulët |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët? | X | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese? | | x | | | |
| | A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese? | | x | | | |
| Ndikimet ekonomike rajonale | A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit? | X | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar? | | X | | | |
| Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik | A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike? | x | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit? | | X | | | |

## Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

| **Kategoria e ndikimeve shoqërore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Vendet e punës[4] | A do të rritet numri aktual i vendeve të punës? | X | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës? | | X | | | |
| | A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit? | | X | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës? | | X | | | |
| Ndikimet shoqërore rajonale | A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta? | | X | | | |
| Kushtet e punës | A ndikohen të drejtat e punëtorëve? | x | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve? | | X | | | |
| Përfshirja sociale | A do të ketë ndikim mbi varfërinë? | | X | | | |
| | A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale? | | X | | | |
| | A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore? | | X | | | |

[4] Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale? | | X | | | |
| Arsimi | A do të ketë ndikim në arsimin fillor? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në arsimin e lartë? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në aftësimin profesional? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen? | | X | | | |
| Kultura | A ndikon opsioni në diversitetin kulturor? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore? | x | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to? | x | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore? | | X | | | |
| Qeverisja | A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik? | | X | | | |
| | A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë? | x | | I Lartë | I Lartë | I Lartë |
| | A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara? | x | | I Lartë | I Lartë | I Lartë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile? | | X | | | |
| Shëndeti dhe siguria publike[5] | A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit? | | X | | | |
| | A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme? | | X | | | |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës? | | X | | | |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë? | | X | | | |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit? | | X | | | |
| | A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si | | X | | | |

[5] Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)? | | | | | |
| Krimi dhe siguria | A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët? | x | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi? | x | | I ulët | I ulët | I ulët |
| | A ndikon në nivelet e korrupsionit? | | X | | | |
| | A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit? | x | | I Lartë | I Lartë | I Lartë |
| | A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit? | | X | | | |

## Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

| **Kategoria e ndikimeve mjedisore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm | A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)? | | X | | | |
| | A do të ndikohet konsumi i karburanteve? | | X | | | |
| | A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit? | | X | | | |
| | A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara? | | X | | | |
| Cilësia e ajrit | A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit? | | X | | | |
| Cilësia e ujit | A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm? | | X | | | |
| Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës | A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në erozionin e tokës? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)? | | X | | | |
| | A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)? | | X | | | |
| Mbeturinat dhe riciklimi | A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të gjeneruara? | | X | | | |
| | A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave? | | X | | | |
| Përdorimi i burimeve | A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)? | | X | | | |
| Shkalla e rreziqeve mjedisore | A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet? | | X | | | |
| | A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore? | | X | | | |
| | A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore? | | X | | | |
| Biodiversiteti, flora dhe fauna | A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar? | | X | | | |
| Mirëqenia e kafshëve | A do të ndikohet trajtimi i kafshëve? | | X | | | |
| | A do të ndikohet shëndeti i kafshëve? | | X | | | |
| | A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve? | | X | | | |

## Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

| **Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Dinjiteti | A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi? | x | | I Lartë | I Lartë | I Lartë |
| Liria | A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes? | x | O.1-X | O.2- I Lartë<br>O.3-I Lartë | I Lartë | I Lartë |
| | A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes? | x | | I Lartë | I Lartë | I Lartë |
| | A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit? | x | | I Lartë | I Lartë | I Lartë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Të dhënat personale | A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale? | | X | | | |
| | A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara? | | X | | | |
| | A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale? | | X | | | |
| Azili | A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil? | | X | | | |
| Të drejtat pronësore | A do të ndikohen të drejtat e pronësisë? | x | | I Lartë | I Lartë | I Lartë |
| | A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes? | | X | | | |
| Trajtimi i barabartë[6] | A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit? | x | | I Lartë | I Lartë | I lartë |
| | A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara? | x | | I Lartë | I Lartë | I Lartë |
| Të drejtat e fëmijëve | A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve? | | x | I ultë | I ultë | I ultë |
| Administrimi i mirë | A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuara? | | X | | | |
| | A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime | x | | I Larte | I Larte | I Larte |

[6] Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)? | | | | | |
| | Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit? | | X | | | |
| | A ndikohet qasja në drejtësi? | | X | | | |